



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 14/31 Prot.

Tiranë më 10/01/2024

V E N D I M

Nr. 5 Datë 20.12.2023

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Suela Bulku Kryesuese
Arben Sefaj Relator
Denisa Sina Anëtar

në datën 20.12.2023, në Godinën e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, kati 1, asistuar nga anëtarja e sekretariatit teknik zj. Lediana Azemaj, zhvilloi seancën dëgjimore publike për çështjen që i përket:

SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT: Z. **Ndue Mark Doçi**, me funksion Drejtor në Drejtorinë Vendore për Kufirin e Migracionin Gjirokastër, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

OBJEKTI: Vlerësimi kalimtar I subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE: Ligji Nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”.
i ndryshuar.

Rregullore nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”.




Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi dëgjoji gjetjet bazuar në arsyetimin ligjor si dhe rekomandimin e relatorit të çështjes Z. Arben Sefaj, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, pasi dëgjoji subjektin e vlerësimit Ndue Mark Doçi, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikën 1, të nenit 4, të Ligjit Nr.12/2018, i ndryshuar.

VËREN:

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi Z. Ndue Doçi është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 05.04.2023, si “Drejtor në Drejtorinë Vendore për Kufirin e Migracionin Gjirokastër, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Subjekti i vlerësimit, Z. Ndue Doçi, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar me datë 05.04.2023, nga Trupat e Vlerësimit, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7, datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
3. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin nr.1 datë 18.04.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: Znj. Suela Bulku Kryesuese Z. Arben Sefaj Relator, dhe Znj. Denisa Sina Anëtar.
4. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197 datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin nr. 1 datë 18.04.2023 vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Ndue Mark Doçi.
5. Relatori i çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 18.04.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, të cilit i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
6. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore me shkresën nr. ***, dt. 24.04.2023 duke e firmosur deklaratën e konfliktit të interesit por pa u shprehur se është apo jo në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës vlerësuese. Nisur nga ky fakt relatori i çështjes i është drejtuar përsëri subjektit të vlerësimit Z. Doçi me emailin zyrtar të datës 19.04.2023, i cili gjendet në dosjen e subjektit, por që subjekti nuk ka kthyer asnjë përgjigje për këtë fakt.

7. Në seancën dëgjimore Kryesuesja e Trupës Vlerësuese ju drejtua subjektit të vlerësimit me pyetjen se “Ju keni deklaruar se nuk ndodhni në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës vlerësuese, gjithashtu edhe gjatë fazës së mbylljes së hetimit paraprak ju nuk keni deklaruar se ndodhni në kushtet e konfliktit të interesit.” Ju qëndroni këtyre deklaramëve: Subjekti u përgjigj se, “*nuk ndodhet në kushtet e konflikt të interesit me asnjë nga anëtarët e Trupës Vlerësuese*”.
8. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
10. Me shkresën nr. *** Prot datë 12.04.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me objekt “Dërgim i formularëve për subjektet e vlerësimit” në përgjigje të shkresës nr.*** Prot. datë 05.04.2023, bashkëlidhur dërgon formularët e deklaramit dhe dokumentacionit të administruar për subjektet e vlerësimit, ndër to edhe për subjektin e vlerësimit Drejtues Ndue Doçi me detyrë Drejtor i Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Gjirokastrë.
11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit Nr.12/2018, i ndryshuar ka për objekt:
 -  Vlerësimin e pasurisë;
 -  Kontrollin e figurës;
 -  Vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
 - a. Ligji Nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
 - b. Ligji nr.128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”,
 - c. Ligji nr.40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”,
 - d. Ligji nr.49/2012, “Për Gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”,
 - e. Ligji nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”,
 - f. Udhëzim Nr.7 datë 17.01.2023, i Ministrit të Brendshëm “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të ligjit Nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar”,
 - g. Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe ILDKPKI nr. 15, datë 27.01.2023, “Për miratimin e formularëve të deklaramit të pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik, si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar,
 - h. Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”,
 - i. Duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht deklaramat e dorëzuara në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore që janë:

 *Deklarata e Pasurisë,*

 *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*

 *Formulari i Vlerësimit Profesional,*

 *Dokumentacioni bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet,*

- j. Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.
- k. Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.
- l. Ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.
13. Trupa e vlerësimit, pasi dëgjoji relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Ndue Doçi, vendosi;
- i. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Z.Ndue Mark Doçi.
- ii. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
- Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht,
 - Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional.
- iii. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018 të ndryshuar, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.
14. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5, i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike", si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018 "Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit Ndue Doçi , u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit nuk kishte zgjedhur mbrojtës ligjor. Gjatë seancës dëgjimore, pas fjalës së relatorit, subjekti i vlerësimit parashtrroi disa shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e vlerësimit në tërësi të kryer ndaj tij (të regjistruar në materialin audio në seancë dëgjimore). Në fund të seancës dëgjimore datë 20.12.2023, subjekti i vlerësimit Ndue Mark Doçi, kërkoi konfirmimin në detyrë.
- Trupa e vlerësimit shpalli vendimin më datën 20.12.2023, për subjektin e vlerësimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

16. Z.Ndue Doçi ka qenë korrekt dhe bashkëpunues gjatë procesit të vlerësimit, duke u përgjigjur brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 2, të nenit 48, të ligjit Nr.12/2018, "Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme", të ndryshuar.

A. VLERËSIMI I PASURISË

17. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
18. Në zbatim të nenit 32, pika 2, e ligjit nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit Z.Ndue Doçi ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 06.03.2023. Formulari i Pasurisë me nr.*** index, 2023.
19. Procedurat e deklaramit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33 ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
20. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
21. Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklaramet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34 , shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.
22. **Trupa e vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:**
 - Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur,
 - Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI,
 - Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike, dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar,
 - Dokumentacionin e paraqitur në deklaramet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike,
23. **Hetimi administrativ konsistoi në:**
 - ✓ Verifikimin e vërtetësisë së deklarameve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
 - ✓ Verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
 - ✓ Evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
 - ✓ Evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarameve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.
24. Z. Ndue Doçi është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2011, me numër indeksi *** dhe sipas deklaramit online me numër indeksi Nr.***. Në zbatim të ligjit nr. 9049, dt. 10.04.2003, "Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, dt.07.04.2005,

“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private.

25. Për kryerjen e kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Ndue Doçi, ILDKPKI ka krahasuar Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, vetting dhe dokumentacionin justifikues bankar, jo bankar, etj të dorëzuar nga vetë subjekti, deklaratat e interesave private ndër vite, me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës me nr.*** prot. dt. 27.04.2023, pranë këtyre institucioneve:

- Banka e Shqipërisë
- Banka Raiffeisen sh.a.
- Banka Kombëtare Tregtare sh.a.
- Banka Intesa Sanpaolo sh.a.
- Banka Tirana sh.a.
- Banka e Bashkuar e Shqipërisë sh.a.
- Banka Procredit sh.a.
- Banka e Parë e Investimeve sh.a.
- Banka Amerikane e Investimeve sh.a.
- Banka Credins sh.a.
- Banka Union sh.a.
- Banka OTP Albania sh.a.
- Raiffeisen Leasing sh.a.
- Porsche Leasing
- Albania Leasing sh.a
- Landeslease sh.a
- RFZ Invest sh.a.
- Credins Invest sh.a.
- Union Financiar i Tiranë sh.a
- AK - Invest sh.a
- EASYPAY shpk
- Fondi BESA sh.a
- Institucioni Financiar NOA sh.a
- IUTECREDIT Albania sh.a
- KREDO FINANCË shpk
- ASHK
- DPSHTRR
- Qendra Kombëtare e Biznesit
- DPT
- ISSH
- DPD
- FSHU
- Shoqëria Rajonale UK Tiranë sh.a
- Shoqëria Rajonale UK Shkodër sh.a

- Shoqëria Rajonale UK Kukës sh.a
- Shoqëria Rajonale UK Lezhë sh.a
- Shoqëria Rajonale UK Dibër sh.a
- Shoqëria Rajonale UK Durrës sh.a
- Shoqëria Rajonale UK Fier sh.a
- Shoqëria Rajonale UK Lushnjë sha
- Shoqëria Rajonale UK Elbasan sh.a
- Shoqëria Rajonale UK Berat sh.a
- Shoqëria Rajonale UK Korçë sh.a
- Shoqëria Rajonale UK Pogradec sh.a
- Shoqëria Rajonale UK Gjirokastrë sh.a
- Shoqëria Rajonale UK Vlorë sh.a
- Shoqëria Rajonale UK Sarandë sh.a
- Vodafone Albania sha
- One Albania sh.a
- Albania Satellite Communications shpk
- ABISSNET sh.a
- DIGICOM shpk

26. Nga Trupa Vlerësuese pranë A.M.P, është kërkuar informacion shtesë pranë institucioneve:

- Regjistrin Noterial Shqiptar,
- Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit,
- Raiffeisen Bank sha,
- Noter Juled Beqiraj.

27. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja:

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, me shkresën nr.*** prot, datë 22.09.2023, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë për vlerësimin kalimtar të subjektit Ndue Doçi”, ILDKPKI në përputhje me ligjin nr. 9049, dt. 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, ligjin nr. 9367, dt. 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, në ligjin nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, bazuar në dokumentacionin e administruar, konstatohet se për subjektin Ndue Doçi;

- deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare,
- nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë,
- nuk është kryer fshehje e pasurisë,
- nuk është kryer deklarim i rremë,
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

28. Bazuar në nenin 32, pika 1.1 të ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar, subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive në rastet e përcaktuara

në pikën 1 të këtij neni, nga viti 2008 dhe në vijim. Neni 32, pika 1, citon; “Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të deklarojnë çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar, nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë”. Subjekti i vlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë në zbatim të Ligjit nr 12/2018, i ndryshuar, si vijon:

DEKLARIMI I PASURIVE

Pasuria nr 1.

a. Apartament banimi me sip. 114,73 m², në adresën Rr.*** nr.***, kompleksi ”****” pallati “***” Tiranë, porositur sipas kontratës së shitjes paraprake, nr.*** rep, nr.*** kol, dt.12.06.2012. Vlera e porositjes së këtij apartamenti është në shumën 5.700.000 lekë, nga të cilat janë paguar 3.200.000 lekë dhe kanë mbetur pa shlyer edhe 2.500.000 lekë. Zotërimi 100%. Burimi i krijimit: 3.200.000 lekë i janë paguar firmës nga vëllai Z.D., si kundër shpërblim për heqjen dorë nga pronësia e një shtëpie banimi te “****”, Tiranë, që unë dhe vëllai kemi pasur në b/pronësi. Deklaratë noteriale nr.*** rep, nr.*** kol, dt. 27.02.2023.

➤ Bashkëlidhur deklaratës:

29. Kontratë shitje paraprake nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 12.06.2012, për apartament me sip. 114,73 m². Blerës: Ndue Doçi. Shitës: D.D. Vlera 5.700.000 lekë. Parapaguar kësti i parë prej 3.200.000 lekë. Pjesa tjetër prej 2.500.000 lekë do të likujdohet me kredi bankare në Raiffeisen Bank. Në rast se pagesat nuk do të bëhen në afatet e përcaktuara në këtë kontratë, kontrata do të quhet automatikisht e zgjidhur. Në rast pagese të menjëhershme klienti do të përfitojë zbritje në masën 10% të çmimit. Mandat arkëtimi dt.11.06.2012, në shumën 3.200.000 lekë për apartament në emër të Ndue Doçi.
30. Vërtetim dt. 03.03.2023, lëshuar nga Njësia Administrative nr. 9, ku vërtetohet se Ndue Doçi, është banues në adresën: Rr. “****”, Nd ****, H.***, Tiranë.
31. Deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 17.04.2018, lëshuar nga Ndue Doçi dhe Z.D, të cilët deklarojnë se Z.D, në datë 11.06.2012 i ka dhënë Ndue Doçit një shumë prej 3.500.000 lekë, për blerjen e pasurisë së ndodhur në Rr. “****”, pranë shkollës “****” dhe ka për t’i dhënë edhe 3.000.000 lekë të tjera, shumë e cila do të likuidohet brenda vitit 2022 dhe pas kyerjes së këtij likuidimi Ndue Doçi, do të heq dorë nga b/pronësia e pasurisë së ndërtuar me kontribut të përbashkët.
32. Deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, dt.05.02.2022, lëshuar nga Z.D, i cili deklaron se i ka likuiduar shtetasit D.D. shumën prej 3.200.000 lekë, për apartamentin në Rr. “****”, të cilin (D.D.) i’a ka kaluar me kontratë paraprake vëllait, Ndue Doçit. Kjo shumë është likuiduar prej tij në zbritje të detyrimit që Z. D. i ka vëllait, nga Shitja e banesës private, shumë e likuiduar në muajin Qershor të vitit 2012. Z.D. deklaron gjithashtu, se gjatë vitit 2017 i ka likuiduar vëllait edhe një shumë tjetër prej 300.000 lekë. Aktualisht mbas këtyre shlyerjeve që ka bërë, i detyrohet vëllait edhe 3.000.000 lekë, shumë të cilën do e shlyej në vazhdim.
33. Deklaratë dt.03.03.2023, nga D.D, ku deklaron se akoma nuk i është paguar shuma prej 2.500.000 lekë, e banesës që ka shitur sipas kontratës paraprake të vitit 2012, kushëririt të tij Ndue Doçi. Kopje pasaporte (SHBA) e shtetasit D.D.

34. Vërtetim dt. 30.03.2022, lëshuar nga shoqëria "****" sh.p.k., që vërteton se Z.D. është punësuar pranë kësaj shoqërie, ku për periudhën 1994 - 2011, ka përfituar 2.163.820 lekë.
35. Vërtetim për bazën e vlerësuar nga ISSH, datë 31.03.2022, për Z. D, ku evidentohet punësimi i tij pranë shoqërisë "****" shpk, për periudhën Janar 2012 - Shkurt 2022, ku sipas pagës së kontributive ka përfituar gjithsej 4.583.380 lekë.
36. Deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 27.02.2023, lëshuar nga Z. D. dhe D. D, të cilët deklarojnë se Z. D, në datë 10.06.2012 ka marrë borxh nga D. D. një shumë prej 25.000 euro.
37. Nxjerrje llogarie nga OTP Bank, për llogari në emër të D. D, ku evidentohet se në dt. 20.09.2007 në llogarinë e tij është transferuar një shumë prej 2.153.068 euro, me përshkrimin nga "Tbiih Finacial Services Group Purchasing Of ****".
38. ASHK Tiranë - DV Zonat e Stimuluara, DV Tirana Veri, DV Tirana Jug, DV Tirana Rurale 1. DV Tiranë Rurale 2, DV Kamëz-Vorë, me shkresat nr.*** prot., dt. 26.06.2023, dt.15.06.2023, dt.26.06.2023, dt.23.03.2023, dt.07.07.2023, nuk konfirmon pasuri në emër të subjektit Ndue Doçi dhe personave të lidhur.
39. ASHK online datë 28.07.2023, konfirmon të regjistruar në b/pronësi pasurinë me nr.7/****, në emër të Ndue dhe L. Doçi.
40. QKB me shkresën nr. *** prot, dt. 09.05.2023, konfirmon se:
- D.D, figuron të jetë regjistruar në QKB si person juridik "****" sh.p.k., me NIPT: M 1191***O. Aktualisht me status aktiv.
 - D.D, figuron të jetë regjistruar në QKB si person juridik "****" sh.p.k., me NIPT: K6791***M. Aktualisht me status ç' regjistrim pa likuidim.
 - D.D, figuron të jetë regjistruar në QKB si person juridik "****" sha., me NIPT: J9132***O. Aktualisht me status aktiv.
 - D.D, figuron të jetë regjistruar në QKB si person juridik "****" sh.p.k, me NIPT: J6190***Q. Aktualisht me status aktiv.
 - D.D, figuron të jetë regjistruar në QKB si person juridik "****" sh.p.k, me NIPT: K7191***N Aktualisht me status aktiv.
 - D.D, figuron të jetë regjistruar në QKB si person juridik "****" sh.p.k., me NIPT: K8211***E. Aktualisht me status aktiv.
 - D.D, figuron të jetë regjistruar në QKB si person fizik me NIPT: L4152***O. Aktualisht me status aktiv.
 - D.D, figuron të jetë regjistruar në QKB si person juridik "****" sh.p.k. me NIPT: L1171***M. Aktualisht me status pezulluar.
 - D.D, figuron të jetë regjistruar në QKB si person juridik "****" sh.p.k., me NIPT: K2182***P. Aktualisht me status aktiv.
 - D.D, figuron të jetë regjistruar në QKB si person juridik "****" sh.p.k. me NIPT: K9210***M. Aktualisht me status aktiv.
 - D.D, dtl. 10.12.1956, figuron subjekti "****" sha, me NIPT K0191***V, i cili nuk ka kryer plotësimin e të dhënave.
41. DPT me shkresën nr. *** prot, dt.11.05.2023, konfirmon se D.D. është regjistruar si tatimpagues me NIPT:
- K6791***M, "****", pranë DRT Lezhë, si aksionar dhe administrator.
 - M1191***O, "****", pranë DRT Durrës, si administrator.
 - K2182***P, "****", pranë DRT Durrës, si administrator.
 - L4152***O, "****", pranë DRT Durrës, si pronar dhe administrator.

- J6190***Q, "****", sh.p.k. pranë DTM, si aksionar dhe administrator.
 - K8211***E, "****", pranë DRT Tiranë, si aksionar dhe administrator.
 - L1171***M, "****", pranë DRT Tiranë, si administrator.
 - K0191***V, "****", pranë DRT Tiranë, si administrator.
42. ISSH, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë me shkresën nr. *** prot, dt. 17.05.2023, konfirmon se D.D, për periudhën 1972 - 1980, ka qenë i punësuar pranë hidrocentralit të Fierzës.
43. ISSH me shkresën nr. *** prot, dt. 10.05.2023, konfirmon se D. D, për periudhën Janar 2012 - Mars 2023, ka qenë i punësuar pranë: *** sh.p.k; ***; ***; *** Tiranë; PF "D.D"; dhe nga muaji Dhjetor 2021, përfiton pension pleqërie me masën aktuale 37.983 lekë.
44. Me inventarin nr.extra prot. datë 10.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:
- ✓ Sqarime me shkrim ku shpjegon se në vitin 2011, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Raiffeisen Bank, arritën një marrëveshje, sipas së cilës, një numër punonjësish të Policisë së Shtetit do të përfitonin kredi të butë në shumën deri në 25.000 euro, ku subjekti ishte një ndër përfituesit e kësaj kredie, duke plotësuar gjithë dokumentacionin e nevojshëm pranë Drejtorisë Ekonomike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Në muajin dhjetor të vitit 2011 subjekti sqaron se ka pasur një problem shëndetësor (****) dhe telefoni i tij ka qenë i mbyllur për më shumë se dy muaj. Duke qenë se numri i telefonit ishte i mbyllur, banka nuk arriti ta kontaktonte dhe e kishte skualifikuar nga përfitimi i kredisë së butë dhe u bë e pamundur marrja e kredisë. Duke qenë se banesën do e blinte nga djali xhaxhait, D.D, pas njohjes së tij me faktin e mos miratimit të kredisë nga Raiffeisen Bank, ranë dakord që shlyerja e këstit të dytë prej 2.500.000 lekë, të likuidohej në një afat tjetër kohor dhe jo me kredi. Dokumente lidhur me këtë aplikim për kredi, subjekti deklaroi se nuk ka arritur ti gjejë edhe pse ka kërkuar, por deklaroi se ky është fakt i cili është i verifikueshëm nga Policia e Shtetit, pasi shumë kolegë të tjerë të tij në atë kohë kanë përfituar nga kjo lloj kredie. Shumën e mbetur detyrim prej 2.500.000 lekë, vëllai Z.D. nuk ja ka shlyer brenda vitit 2022, por e ka shlyer përfundimisht më datën 03.05.2023, nëpërmjet Raiffeisen Bank. Lidhur me burimin financiar të shumës 3.200.000 lekë, për vëllain Z.D, për këstin e parë të blerjes së apartamentit, subjekti sqaron se vëllai Z.D. e ka krijuar këtë shumë nga të ardhurat e tij familjare ndërvite dhe huaja e marrë nga djali i xhaxhait D.D, sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, datë 27.02.2023. Për sa i përket shumës 2.500.000 lekë, mbetur detyrim ndaj D.D. për blerjen e apartamentit, subjekti shpjegoi se deri më datë 06.03.2023 nuk e kishte shlyer ende, pasi nuk kishte marrë akoma lekët nga vëllai i tij. Këtë detyrim e ka shlyer më datë 19.06.2023, vërtetuar nga deklarata noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, datë 22.06.2023. Për mobilimin e apartamentit, subjekti sqaroi se apartamenti ishte mobiluar më parë nga kushëri i tij, pronari (i mëparshëm), D.D, i cili jetonte në atë apartament.
 - ✓ Fletë dalje dt. 13.12.2011, nga Spitali Gjerman, për pacientin Ndue Doçi, me diagnozë "****".
 - ✓ Deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 22.06.2023, lëshuar nga Z.D. dhe Ndue Doçi, ku Z.D. deklaroi se ka paguar nëpërmjet OTP Bank, shumën 3.000.000 lekë në datë 06.03.2023, duke shlyer detyrimin e blerjes së pasurisë së ndodhur në Rr. "****".
 - ✓ Faturë dt. 15.11.2022, për shumën 2.117.647 lekë, lëshuar nga shitësi Z.D. me nr. personal G6012***F, për blerësin "****" sh.p.k, për shërbime punimesh.
 - ✓ Faturë dt. 30.11.2022, për shumën 1.411.764 lekë, lëshuar nga shitësi Z.D. me nr. personal G6012***F, për blerësin "****" sh.p.k, për shërbime punimesh.

- ✓ Urdhër-transferete nga OTP Bank, dt. 03.05.2023, në shumën 3.000.000 lekë, transferuar nga klienti Z.D, për përfituesin Ndue Doçi në Raiffeisen Bank, me përshkrimin "kalim sipas deklaratës noteriale nr.*** rep, nr. *** kol. dt.05.02.2022.
 - ✓ Prokurë e përgjithshme nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 13.06.2019, me anë të së cilës D.D. dhe M. D, kanë emëruar si përfaqësues të përgjithshëm, shtetasin D.D.
 - ✓ Kontratë shitje nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 15.06.2023, për pasurinë e llojit apartament me sip.107 m² me nr. pasurie 7/***, në Rr."****", Tiranë. Blerës: Ndue Doçi. Shitës: D.D, dhe M.D. (përfaqësuar me prokurë nga D. D). Çmimi: 5.700.000 lekë. Vlera 3.200.000 lekë, likuiduar sipas kontratës së shitjes paraprake datë 12.06.2012 dhe vlera 2.500.000 lekë do të likuidohet nëpërmjet kalimit në llogarinë e noterit. Kontratë shitje paraprake dt.12.06.2012, për apartament me sip. 114,73 m² në Rr. "****", Tiranë. Shitës: D.D. Blerës: Ndue Doçi. Çmimi: 5.700.000 lekë. Mandat arkëtimi dt. 11.06.2012, në shumën 3.200.000 lekë për apartament në emër të Ndue Doçi.
 - ✓ Njoftim debitimi nga Raiffeisen Bank, dt.19.06.2023, për transferimin e shumës 2.500.000 lekë nga klienti urdhërues, Ndue Doçi për klientin përfitues, Xh. B. PF, me përshkrimin "kalim sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 16.06.2023".
 - ✓ Deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 22.06.2023, lëshuar nga D.D, M.D. (përfaqësuar me prokurë nga D.D.) dhe Ndue Doçi, të cilët deklarojnë se është lidhur kontrata e shitblerjes nr.*** rep, nr.*** kol, dt.15.06.2023, për shitjen e pasurisë së paluajtshme apartament me sip. 107m², me nr. pasurie 7/***, në Rr. "****", Tiranë. Vlera prej 2.500.000 lekë, si këst i fundit për blerjen e apartamentit i pa likuiduar deri më dt. 06.03.2023, është likuiduar më dt. 19.06.2023, nëpërmjet kalimit në llogarinë e noterit në Raiffeisen Bank. Me likuidimin e këtij kësti, Ndue Doçi nuk ka më detyrime të tjera në lidhje me këtë apartament.
 - ✓ Certifikatë regjistrim pronësie dt. 27.06.2023, për pasurinë e llojit apartament me sip. 107 m², me nr. pasurie 7/***, në Rr. "****", Tiranë, regjistruar në emër të L. Doçi për 1/2 pjesë.
45. Me inventarin nr.extra prot. datë 18.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI: Sqarime me shkrim ku shpjegoi se pas pagesës së këstit të dytë, bërë më datë 03.05.2023, kanë nënshkruar me vëllain Z.D. deklaratën noteriale nr. *** rep, dhe nr. *** kol, dt. 14.07.2023, ku subjekti ka hequr dorë nga pjesa takuese e shtëpisë një kat, duke i njohur kështu të drejtën vëllait të bëjë regjistrimin e banesës pranë ASHK. Për burimin financiar të shumës 3.000.000 lekë të këstit të dytë të paguar nga vëllai, subjekti shpjegoi se këtë shumë, vëllai Z.D. e ka siguruar nga puna e bërë gjatë viteve në kompani të ndryshme dhe nga kursimet familjare. Kjo shumë ka kaluar nëpërmjet bankës dhe bashkëlidhur janë faturat përkatëse të kalimit të parave nga blerësi *** Shpk, tek shitësi Z.D. dhe më pas në llogarinë e subjektit në Raiffeisen Bank. Gjithashtu vëllai ka bashkëshorten e punësuar dhe dy djem emigrant në Angli. Sqaroi se vëllai nuk ka krijuar asete të tjera përgjatë këtyre viteve, si dhe nuk e ka shlyer ende detyrimin prej 25.000 euro, të marra nga djali i xhaxhait D.D.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 14.07.2023, lëshuar nga Ndue Doçi dhe Z.D, me anë të së cilës Ndue Doçi heq dorë nga pronësia/bashkëpronësia e pjesës takuese e pasurisë së paluajtshme shtëpi l- katëshe të ndodhur në Rr. "****", Tiranë, duke ia kaluar pjesën e tij takuese vëllait, Z.D. i cili mund të kryejë të gjitha veprimet për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme në emrin e tij. Deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 14.07.2023, lëshuar nga Ndue Doçi dhe D.D e M.D, përfaqësuar me prokurë nga D.D, të cilët sqarojnë lidhur me gabimin e ndodhur me kontratën paraprake të datës 12.06.2012, e cila i është bashkëlidhur kontratës përfundimtare të shitjes së apartamentit.

46. Certifikatë regjistrimi pronësie për apartament me sip. 107 m², me nr. pasurie 7/****, në Rr. ****, Tiranë, regjistruar në emër të Ndue Doçi për 1/2 pjesë takuese.
47. Çertifikatë regjistrimi pronësie për apartament me sip. 107 m², me nr. pasurie 7/**** në Rr. ****, Tiranë, regjistruar në emër të L. Doçi për 1/2 pjesë takuese.
48. Kartela e pasurisë së paluajtshme për pasurinë e llojit apartament me sip. 107 m², me nr. pasurie 7/****, në Rr. ****, Tiranë, regjistruar në emër të Ndue dhe L. Doçi për 1/2 pjesë takuese secili, në vlerën 5.700.000 lekë, regjistruar sipas kontratës nr.*** rep. dhe nr.*** kol dt. 15.06.2023.
49. Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, për llogari në emër të L.D, në të cilët evidentohet kreditimi i pagave për periudhën 12.01.2017 - 04.07.2023, në shumën 3.613.659 lekë.

❖ **Hetimi kryer nga Trupa vlerësuese pranë AMP:**

50. Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezultojnë se:

Apartamenti me sip. 114,73m², në Rr. **** në Tiranë, me çmim 5.700.000 lekë, në zotërim 100% të subjektit, është përfituar me kontratë paraprake shitje Nr.*** rep datë 12.06.2012, kur u krye pagesa e kështit të parë prej 3.200.000 lekë dhe detyrimi ndaj shitësit ishte në shumën 2.500.000 lekë. Kjo shumë, si kësht i dytë dhe i fundit është paguar nga subjekti në qershor 2023. Si burim financiar subjekti ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e pjesës së tij takuese të shtëpisë në b/pronësi me vëllain Z.D. në Rr. ****, në shumën 3.200.000 lekë dhe 2.500.000 lekë, paguar respektivisht në vitin 2012 dhe 2023, materializuar me deklaratë noteriale heqje dorë dhe jo kontratë shitje.

Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion lidhur me burimin financiar të pagesave të vëllait Z. D, për blerjen e pjesës takuese në shtëpinë e përbashkët.

Pagesa e kështit të dytë dhe regjistrimi i kësaj pasurie është bërë në qershor 2023, pas dorëzimit të Deklaratës së Pasurisë Vetting.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me shpjegimet e dhëna dhe përgjigjen e ASHK Online. Certifikata e pronësisë e paraqitur mban datën 27.06.2023.**
- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me burimin financiar të përdorur për blerjen e apartamentit në Rr. **** Tiranë, nga shitja e pjesës takuese të shtëpisë së banimit vëllait të tij Z. D. (trajtuar më poshtë).**

Pasuria nr 2.

51. b. Shtëpi banimi 1-kat, me sip. 132,9 m² dhe truall me sip. 400 m², me nr. pasurie 9/****, zk. ****, pranë shkollës ****, në ****, Tiranë në bashkëpronësi me vëllain tim Z.D. Vlera 0 lekë. Zotërimi 1/2 për truallin me sip. 400 m². Në këtë pronë edhe pse certifikata e pronësisë është në b/pronësi mes meje dhe vëllait tim, unë nuk kam pretendime pronësore për shtëpinë, pasi nga pjesa ime takuese kam hequr dorë (shitur) prej vitit 2012, kur vëllai pagoi shumën 3.200.000 lekë për porositjen e apartamentit ku jetoj në Rr.****. Në këtë pronë unë kam

b/pronësinë vetëm për ¹/2 pjesë të truallit me sip. 400 m². Shtëpinë në fjalë ja kam shitur vëllait në vitin 2012, për shumën 6.500.000 lekë. Nga kjo shumë vëllai ka paguar 3.200.000 lekë për porositjen e apartamentit dhe 300.000 lekë të tjera paguar për përdorim familjar. Aktualisht vëllai ka ende detyrim pa paguar edhe diferencën e mbetur prej 3.000.000 lekë. Shtëpia është ndërtuar nga unë dhe vëllai në vitin 1994 dhe ka pasur një kosto totale prej rreth 400.000 lekë, ku pjesa ime e shpenzimeve ka qenë rreth 200.000 lekë, me burim financiar: *Të ardhura të krijuara nga puna ime në emigracion në Greqi.*

52. **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vetëdeklarim për legalizim objekti dt.08.09.2006, për shtëpi banimi 1 kat, ndërtuar në vitin 1994 me sipërfaqe të zënë 611m² dhe sipërfaqe ndërtimi 116 m². Deklaruar Ndue Doçi dhe Z.D.
- Mandat arkëtimi nr. ***, dt. 08.09.1993, për blerje në shumën 105.450 lekë, në emër të Ndue Doçi. Fletë dalje nr. ***, dt. 08.09.1993 nga firma "****", për materiale ndërtimi në shumën 105.450 lekë, në emër të Ndue Doçit.
- Mandat arkëtimi nr. **, dt. 04.08.1994, për blerje në shumën 169.450 lekë, në emër të Ndue Doçi.
- Fletë dalje nr. ***, dt. 04.08.1994, nga firma "****", për materiale ndërtimi në shumën 169.450 lekë, në emër të Ndue Doçit.
- Mandat arkëtimi nr.***, dt.16.09.1994, për blerje, shuma 112.700 lekë, në emër të Ndue Doçi.
- Fletë dalje nr. ***, dt. 16.09.1994, nga firma "****", për materiale ndërtimi në shumën 112.700 lekë në emër të Ndue Doçit.
- Planvendosja e objektit 1 kat, pronë e familjes Doçi, me sip. trualli 611 m².
- Plani i katit përdhe për objektin me sip. 116,32 m² dhe sip. verande 16,482 m².
- Leje legalizimi nr. ***, dt. 11.12.2020, në emër të Z.D. dhe Ndue Doçi, për godinë banimi 1 kat, me sipërfaqe ndërtimi dhe banimi 132,9 m² dhe parcelë ndërtimore 400 m². Ortofoto dhe foto të ndërtesës.
- Njoftim nr.*** prot., dt. 14.10.2021, nga ASHK, drejtuar Z.D. dhe Ndue Doçit, ku i informon lidhur me llogaritjen e vlerës së parcelës ndërtimore, pagesën e detyrimeve financiare dhe depozitim të mandateve të pagesave, për shumën 288.000 lekë dhe 400.000 Bono Privatizimi.
- Mandat depozitimi në Credins Bank dt. 18.10.2021, i shumës 288.000 lekë, bërë nga Z.D. për ASHK Tiranë me përshkrimin “derdhje nga të tretë”, Z. dhe Ndue Doçi.
- Mandat depozitimi në Credins Bank dt. 18.10.2021, i shumës 400.000 Bono Privatizimi, bërë nga Z. D. për ASHK Tiranë, me përshkrimin “derdhje nga të tretë”, Z.D. dhe Ndue Doçi.
- Kërkesë pranë ZVRPP Tiranë, nr. ***, dt. 19.10.2021, bërë nga Z.D.
- Mandat arkëtimi dt. 20.10.2021, shuma 4.600 lekë, bërë nga Z.D. në favor të ZVRPP Tiranë.
- Kërkesë pranë ZVRPP Tiranë, nr.***, dt.15.11.2021, bërë nga Z.D, për regjistrimin e kalimit të pronës.
- Mandat arkëtimi dt.19.11.2021, në shumën 5.100 lekë, bërë nga Z.D. në favor të ZVRPP Tiranë.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 17.04.2018, lëshuar nga Ndue Doçi dhe Z.D, të cilët deklarojnë se Z.D, në datë 11.06.2012 i ka dhënë Ndue Doçit një shumë prej 3.500.000

lekë për blerjen e pasurisë së ndodhur në Rr. “****”, pranë shkollës “****” dhe ka për t’i dhënë edhe 3.000.000 lekë të tjera, shumë e cila do të likuidohet brenda vitit 2022 dhe pas kryerjes së këtij likuidimi Ndue Doçi, do të heq dorë nga bashkëpronësia e pasurisë së ndërtuar me kontribut të përbashkët.

- Deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 05.02.2022, lëshuar nga Z.D, i cili deklaron se te shtetasi D.D. ka likuiduar shumë prej 3.200.000 lekë për apartamentin në Rr. “****”, të cilin ia ka kaluar me kontratë paraprake vëllait të tij, Ndue Doçit. Kjo shumë është likuiduar prej tij në zbritje të detyrimit që i ka vëllait nga shitja e banesës private, shumë e likuiduar në muajin qershor të vitit 2012. Z.D deklaron gjithashtu se gjatë vitit 2017 i ka likuiduar vëllait edhe një shumë prej 300.000 lekë. Aktualisht mbas këtyre shlyerjeve që ka bërë, i detyrohet vëllait edhe 3.000.000 lekë, shumë të cilën do e shlyej në vazhdim.
- Njoftim për adresën e vendbanimit nga Bashkia Tiranë, për adresën: Rr. “****”, Nd. ***, H. ***, Njësia Bashkiake nr. 9, Kodi Postar 1016, Tiranë.
- Vërtetim dt.03.03.2023, lëshuar nga Njësia Administrative nr. 9, e cila vërteton se Z.D, është banues në adresën: Rr. “****”, Nd.***.
- Vërtetim dt.03.03.2023, lëshuar nga Njësia Administrative nr. 9, e cila vërteton se Ndue Doçi, është banues në adresën: Rr. “****”, Nd. ***, H.***.

❖ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese pranë AMP:**

53. ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, me shkresën nr. *** prot, dt. 26.06.2023, konfirmon se në emër të Ndue Doçi, rezulton e regjistruar pasuria e llojit truall me sip. 400 m² + ndërtesë me sip. 132,90 m², me nr. pasurie 9/****, në b/pronësi me Z.D. Sipas përshkrimit të kartelës së pasurisë, pasuria është rregjistruar me Leje Legalizimi nr.***, dt. 14.12.2020, godinë banimi 1-kat.
54. ASHK online datë 28.07.2023 në emër të Ndue Doçi dhe Z.D, konfirmon të regjistruar në b/pronësi pasurinë nr. 9/****, sipas Leje Legalizimi nr.*** dt.14.12.2020, godinë banimi 1-kat, sip katit përdhe 132,9 m².
55. Subjekti ka sqaruar me shkrim se burimin financiar për ndërtimin e banesës së vitit 1994, e ka siguruar nga puna në emigracion në Greqi, gjatë viteve 1992 - 1994. Duke qenë se në atë periudhë ishin vitet e para të emigracionit të shqiptarëve, ishte e pamundur të merrje vizë pune apo të punoje me dokumentacion të rregullt në Greqi, ndaj kam punuar i pasiguruar dhe i pa regjistruar pranë zyrave të punës në shtetin Grek.
56. Në lidhje me vlerën e ulët të ndërtimit, subjekti sqaroi se në ndërtimin e banesës, ndihmë ka dhënë djali i xhaxhait D.D, i cili në atë kohë po ndërtonte një pallat ngjitur me banesën me kompaninë e tij "****" sh.p.k., kompani kjo e cila është themeluar prej vitit 1991 dhe regjistruar në QKB në vitin 1993. Shumicën e materialeve të ndërtimit si çimento, granil, rërë, hekur, pllaka, hidrosanitare dhe fuqi punëtore i ka ofruar falas ose me çmim të shumicës.
57. Shtëpia është ndërtuar nga subjekti dhe vëllai i tij në vitin 1994 dhe ka pasur një kosto totale prej rreth 400.000 lekë, ku pjesa ime e shpenzimeve ka qenë rreth 200.000 lekë, me burim financiar: *të ardhura të krijuara nga puna ime në emigracion në Greqi.*

58. Në lidhje me këtë deklaram të subjektit të vlerësimit z. Ndue Doçi referuar koston së ndërtimit të vitit 1995 pasi për vitin 1994 nuk ka të përlllogaritur një kosto të tillë, por merret kostoja e ndërtimit të vitit më të afërt, e për rastin konkret është viti 1995, rezulton se:
Sipërfaqja e ndërtimit sipas çertifikatës së pronësisë dhe deklaramit të vetë subjektit është 132.9 m². Në vitin 1995 kostoja e ndërtimit për qytetin e Tiranës është 12.883 lekë.
Nga përlllogaritja rezulton se kostoja e ndërtimit të banesës me sipërfaqen e mësipërme është 1.712.150 lekë. ($132.9 \times 12883 = 1.712.150 \text{ lekë}$).
59. Sipas Entit Kombëtar të Banesave i cili përlllogarit koston e ndërtimit sipas viteve rezulton se për vitin 1995, i cili është viti më i afërt i përlllogaritjes së kostove të ndërtimit, pasi viti 1994 nuk ka një përlllogaritje të tillë, rezulton se kostoja mesatare e ndërtimit për vitin 1995 e përlllogaritur nga Enti Kombëtar të banesave për Tiranën është 12.883 lekë m² sipërfaqe ndërtimi. Nisur nga ky fakt për një sipërfaqe ndërtimi 132.9 m² x 12.883 lekë m² = 1.712.150 lekë. Për këtë konstatim të trupës së vlerësimit u pyet subjekti i cili në përgjigjen e tij të protokolluar me tonën nr. 14/21 datë 10.11.2023, jep shpjegimin e mëposhtëm:
Familja ime ndërtimin e banesës një katesh e ka nisur në vitin 1992 dhe e kemi përfunduar në vitin 1994. Ndërtimi i saj ka zgjatur gati 3 vite dhe, kjo pasuri nuk ka asnjë lidhje me detyrën time që kam sot dhe ato që kam ushtruar në karrierën time. Është pasuri familjare e krijuar para fillimit të detyrës. Subjekti i vlerësimit ka paraqitur edhe një preventiv punimesh të datës 14.05.1993, ku paraqiten disa zëra punimesh. Preventivi mban shumën 437.434 lekë.
Lidhur me vlerën e kësaj banese, të deklaram ndër vite për shumën 25.000 euro, subjekti sqaroi se në deklaramin e bërë ka menduar se vlera e banesës në kohën e deklaramit në treg ishte 25.000 euro
- ✓ **Në konkluzion të veprimeve të mësipërme Trupa Vlerësuese pranë AMP bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i vlerësimit si edhe në vetëdeklaramin e tij arrin në përfundim se vlera e ndërtimit e shtëpisë 1-katë me sipërfaqe 132.9 m² në bazë të përlllogaritjeve të koston së ndërtimit është e barabartë me 1.712.150 lekë, pa përfshirë këtu koston e blerjes së truallit me sipërfaqe 400 m².**
60. Në lidhje me blerjen truallit të ndërtimit me sipërfaqe 400 m² në adresën e mësipërme u pyet subjekti i vlerësimit me e-mailin e datës 02.11.2023 dhe në kthim përgjigjen e tij, protokolluar me tonën nr. *** prot. datë 10.11.2023 subjekti sqaron se:
Historiku i fitimit të pronësisë nis në vitet 1990, kur filloi dhe lëvizja demografike nga zonat malore (dhe çdo rajon tjetër i vendit). Ka qenë një vendim i familjes sime të origjinës zhvendosja nga vendlindja (zonë e thellë malore në Lurë, Dibër). Unë thjesht kam ndjekur familjen time si pjestar i saj. Në atë kohë procesi i shkollimit tim nuk kishte përfunduar, kështu që detyrimisht do të zhvendosesha bashkë me familjen.
- ✓ **Konfirmohet deklaramit me dokumentacionin e dorëzuar dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i vlerësimit.**
61. Për mobilimin e shtëpisë, subjekti sqaroi se mobiljet duke përfshirë dhe pajiset elektroshtëpiake i kanë blerë të gatshme dhe kryesisht të përdorura tek tregu i elektroshtëpiakeve, tek Pazari i Ri në Tiranë. Shuma e blerjeve nuk i kujtohet sepse i ka blerë pjesë - pjesë në ato vite, por për mobilimin dhe elektroshtëpiake kanë shpenzuar një shumë rreth 60.000 lekë. Duke qenë mallra të përdorura dhe të gatshme, nuk i kanë blerë me faturë, ndaj dhe nuk disponon fatura blerjeje.

Në vijim të shpjegimeve, subjekti sqaroi se pjesën takuese të shtëpisë së banimit ia ka shitur vëllait Z.D, në vitin 2012 dhe nuk kanë bërë në atë kohë kontratë shitblerje, pasi ishte marrëdhënie vëllazërore dhe nuk ishte e nevojshme për kontratë noteriale. Adresa e banimit të vëllait Z.D. është Rruga "****", Nd.*** H. ***, Njësia Bashkiake nr. 9, Kodi Postar 1016, Tiranë (shtëpia në fjalë).

62. Në pyetësorin shtesë për subjektin e vlerësimit drejtuar nga trupa vlerësuese në lidhje me daklaratën noteriale nr. *** rep. dhe *** kol. datë 27.02.2023, ku është deklaruar se shpenzimet për shkollimin e djalit tuaj në Universitetin privat "****" janë financuar nga kushëriri juaj D.D. në vlerën e 4.000 euro, përse kjo deklaratë nuk është bërë në momentin e fillimit të procesit mësimor por para dorëzimit të deklaratës për efekt procesi të vlerësimit subjekti sqaron se:

“Marrja përsipër e shpenzimeve të studimit nga djali i xhaxhait tim, është në vazhden e ndihmës familjare që nga viti 1990, e në vijim, e lidhur dhe me marrëdhënien e posaçme që unë dhe kushëriri im kemi me njëri tjetrin, me marrëdhëniet personale me fëmijët e mi, për shkak të rezultateve të larta në shkollë dhe pamundësisë sime financiare...”

Trupa vlerësuese pranë AMP vëren se në kthim përgjigjen e tij subjekti deklaroi se *nisur nga marrëdhëniet shumë të mira familjare dhe që është në vazhden e ndihmës familjare që nga viti 1990 e në vijim, kjo edhe nga marrëdhëniet e posaçme që subjekti ka me kushëririn e tij.*

Në deklaratën e tij noteriale (Financim me kusht punësimi) nr.*** rep. dhe *** kol. datë 27.02.2023, deklaruesi D.D. deklaroi se *“Financimi bëhet me kusht që përfituesi S. Doçi mbas mbarimit të universitetit të punojë pranë shoqërisë “****” shpk për një periudhë prej 5 vitesh.”*

Në të *“kundërt ky i fundit S. Doçi detyrohet ti kthejë financuesit D.D. dyfishin e shumës së financuar prej tij”.*

Trupa vlerëson se ashtu sic deklarohet në deklaratën noteriale financimi është “Financim me kusht” që djali i subjektit të punojë në kompaninë “****” shpk për një periudhë 5 vjecare dhe jo sipas një marrëdhënie familjare e konsoliduar dhe pandërprerje, në të kundërt detyrohet që shuma e financuar për shkollimin e tij do të kthehet në masën dyfish, por gjithësesi pa përjashtuar dhe nevojën e shoqërisë për specialistë e kryesisht për Inxhinierë Saftwer.

63. Trupa e vlerësimit i është drejtuar subjektit të vlerësimit z. Ndue Doçi në lidhje me deklaratën noteriale "Për njohje detyrimi ose shume në të holla" me nr. *** rep. dhe *** kol. datë 27.02.2023 ku shtetasi Z.D. deklaroi se *"unë deklaruesi Z.D deklaroj se me datë 10.06.2012 kam marrë hua/borxh nga z. D.D, shumën prej 25.000 euro", ndër të tjera subjekti thekson se, “Por në çdo rrethanë vëllai im, nuk është person i lidhur, as person tjetër i lidhur, për shkak se marrëdhëniet financiare (huamarrje), nuk i ka me mua dhe unë nuk kam pasur marrëdhënie të tillë me vëllain (për shkak të pamundësisë sime ekonomike, po të disponoja unë vlera monetare, huanë do ta merrte tek unë)”.*

Në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, neni 3, “Përkufizime” pika 14, *“Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, të cilët duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me punonjësin, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi gjatë periudhës së vlerësimit.* Në deklaratimet e subjektit në deklaratën e pasurisë për vlerësimin kalimtar ka deklaruar se burimi i krijimit të apartamentit me sip. 114.73 m² në adresën nr. “****” shuma prej 3.200.000 lekë, i janë paguar firmës nga vëllai Z.D. si kundërshtëpërlim për heqjen dorë nga pronësia e një shtëpie banimi të “****” sipas deklaratës nr.*** rep. dhe nr.***

kol. datë 27.02.2023. Po kështu në kthim përgjigjet në korespondencë me ILDKPKI subjekti është shprehur se shuma prej 3.200.000 lekë për këstin e parë të blerjes së apartamentit në adresën rr. "****" vëllai im Z.D. e ka krijuar nga të ardhurat e tij familjare ndër vite dhe nga një hua e marrë nga djali i xhaxhait D.D. sipas kontratës nr. *** rep. dhe *** kol. datë 27.02.2023. Në kuptim të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, neni 3, pika 14, vëllai juaj Z.D. është person tjetër i lidhur që rrjedh nga një interes pasuror, pasi shuma e marrë hua nga vëllai jua ka shërbyer për blerjen e apartamentit tuaj në adresën rr. "****" nr. *** kompleksi "****" pallati "****".

64. Subjekti shpjegoi se deri në vitin 2012, nuk ka asnjë shpenzim/investim tjetër te kjo banesë, ndërsa nga ana e vëllait të tij janë bërë riparime të pjesshme dhe lyerje gjatë viteve të mëvonshme. Për pagesën e këstit të parë të paguar nga vëllai në shumën 3.500.000 lekë, subjekti sqaroi se e gjithë shuma i është likuiduar nga vëllai në vitin 2012. Deri në qershor të vitit 2012, vëllai Z.D., ka paguar 3.200.000 lekë tek D.D., për pagesën e apartamentit dhe 300.000 lekë të tjera ia ka paguar subjektit, pra gjithsej vëllai ka paguar 3.500.000 lekë.
65. Deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 14.07.2023, lëshuar nga Ndue dhe Z.D, me anë të së cilës Ndue Doçi heq dorë nga pronësia/bashkëpronësia e pjesës takuese e pasurisë së paluajtshme shtëpi 1-katëshe të ndodhur në Rr. "****", Tiranë, duke ia kaluar pjesën e tij takuese vëllait, Z.D, i cili mund të kryejë të gjitha veprimet për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme në emrin e tij.
66. Për parcelën ndërtimore (truallit me sip. 400 m²), për të cilën janë paguar 288.000 lekë dhe 400.000 lekë në Bono Privatizimi, ka paguar pjesën e tij në shumën 144.000 lekë dhe 200.000 në Bono Thesari, ndërsa diferenca tjetër është paguar nga vëllai.
67. Bazuar në deklarimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:
Shtëpia e banimit në Rr. "****", në Tiranë deklarohet se është ndërtuar nga subjekti dhe vëllai i tij në vitin 1994, ku pjesa e shpenzuar nga secili prej tyre ka qenë rreth 200.000 lekë, me burim financiar të ardhurat nga puna e tij në emigracion në Greqi, si dhe ndihma që kanë marrë në materiale dhe punëtori nga kushëriri i tyre D.D, sipërmarrës në shoqërinë ndërtuese "****" shpk. Kjo shtëpi është regjistruar me procesin e legalizimit së bashku me një truall me sip. 400 m². Në vitin 2012, pjesën e vet takuese të kësaj banese, subjekti ia ka shitur vëllait të tij për shumën 6.500.000 lekë, dhe i mbetet pjesë takuese vetëm në truallin rreth shtëpisë me sip. 400 m². Në vitin 2012, vëllai i ka paguar 3.500.000 lekë (shumë me të cilën subjekti ka paguar këstin e parë për blerjen e apartamentit prej 3.200.000 lekë) dhe 3.000.000 lekë në vitin 2023 (shumë me të cilën subjekti ka paguar këstin e dytë për blerjen e apartamentit prej 2.500.000 lekë).
68. ASHK konfirmon të regjistruar pasurinë truall me sip. 400 m², ndërtesë 1 kat, me sip.132,90 m², në bashkëpronësi të Ndue dhe Z.D, përfituar me Leje Legalizimi të vitit 2020 me adresë në Rr. "****" Tiranë.
- ✓ Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me shitjen e pjesës takuese dhe heqjen dorë në vitin 2012 nga b/pronësia e shtëpisë (jo truallit) në favor të vëllait Z.D. dhe ka paraqitur deklaratat noteriale përkatëse. Shitja/heqja dorë nga pjesa e pasurisë nuk është bërë me kontratë shitje por me deklaratë noteriale.

- ✓ Shuma monetare e pa paguar (e pashlyer) ende nga vëllai Z.D, për shitjen e shtëpisë të "****", Tiranë, shumë e cila do të paguhet nga vëllai në të ardhmen. Vlera 3.000.000 lekë. Zotërimi 100%.
- ✓ Lidhur me faktin se në deklaratën e interesave privatë 2021, interesin privat me vëllain e ka deklaruar në formë huadhënie për shumën 6.500.000 lekë, kjo ka ndodhur për arsye se në vitin 2021 ka kryer për herë të parë deklarin online dhe duke mos pasur një njohuri të plotë mbi mënyrën e deklarimit dhe rubrikat përkatëse, shumën e shitjes së shtëpisë prej 6.500.000 lekë e ka deklaruar në formë huadhënie, por në brendësi të deklaratës në rubrikën "Shënime" e ka sqaruar saktë interesin privat që ka pasur me vëllain, ku prej tij deri në datën e dorëzimit të deklaratës kishte marrë 3.500.000 lekë dhe kishte për të marrë edhe 3.000.000 lekë të tjera.

Pasuria 3

69. c. Autoveturë Mercedes Benz, me targa AA *** GT. Këtë automjet e kam pasur në përdorim prej vitit 2008 dhe në vitin 2013, kam lidhur kontratën e shitblerjes nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 10.06.2013. Burimi i krijimit: Kursimet familjare ndër vite. Vlera 7.500 euro. Zotërimi 100%. Bashkëlidhur deklaratës:
- Kontratë shitje nr.*** rep, nr.*** kol, dt. 10.06.2013, për automjet Daimler Chrysler, me targa LA *** A. Blerës: Ndue Doçi. Shitës: A. B. Çmimi: 7.500 euro i likuiduar jashtë zyrës noteriale.
 - Deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 03.02.2022, lëshuar nga A.B, i cili deklaron se në vitin 2008, ka blerë një automjet Mercedes Benz, me targa LA *** A dhe prej atij viti ia ka lënë në përdorim në mirëbesim Ndue Doçit dhe për shkak të marrëdhënies miqësore nuk kanë nënshkruar kontratë. Kontratën e kanë nënshkruar në datën 10.06.2013, për vlerën 7.500 euro. Këtë automjet e ka blerë në shumën 8.000 euro por ka bërë ulje në çmim në shumën 500 euro për shkak të marrëdhënies miqësore.
70. DPSHTRR me shkresën nr. *** prot, dt.22.05.2023, konfirmon se Ndue Doçi ka të regjistruar në pronësi automjetin me targa AA *** GT. Bashkëlidhur:
- Kontratë shitje nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 03.01.2008, por që në kronologji të veprimeve rezultojn se data e blerjes nuk është 03.01.2008, por 03.01.2009, për automjet Daimler Chrysler, me targa LA***A. Blerës: A. B. Shitës: B. K. Çmimi: 8.000 euro i likuiduar.
 - Kontratë shitje nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 10.06.2013, për automjet Daimler Chrysler, me targa LA *** A. Blerës: Ndue Doçi. Shitës: A. B. Çmimi: 7.500 euro likuiduar jashtë zyrës noteriale.
 - Sqarime me shkrim ku ka shpjeguar se shumën 7.500 euro, për blerjen e automjetit, e ka paguar në muajin dhjetor të vitit 2008, kur edhe ka marrë automjetin. Bazuar në deklarin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezultojn se: Automjeti Mercedes Benz është marrë në përdorim nga subjekti në vitin 2008, kur edhe ka paguar çmimin e blerjes prej 7.500 euro, por kontrata e shitblerjes është lidhur në vitin 2013, për shkak të marrëdhënies miqësore që subjekti ka pasur me shitësin e automjetit, A.B.(kunati i tij, evidentuar me poshtë).

- Pyetjes se, “Keni deklaruar se në vitin 2008 keni blerë një mjet me kontratë shitje nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 03.01.2008, por që në kronologji të veprimeve rezulton se data e blerjes nuk është 03.01.2008 por 03.01.2009 për automjet Daimler Chrysler, me targa LA *** A. Sipas shkresës nr. *** datë 22.05.2023 të DPSHTRR rezulton kontrata e shitblerjes me datë 12.02.2008 me shitës A.D dhe blerës B.K. Kurse kontrata me shitës B. K. dhe blerës A.B. (që rezulton pas datës 12.02.2008) mban datën 03.01.2008. Sqaroni kur është viti kur ju keni blerë mjetin, Daimler Chrysler, me targa LA*** A, subjekti i vlerësimit ju përgjigj se: *Sqaroj se në deklaratën time të pasurisë, unë kam deklaruar se automjetin në fjalë e kam në përdorim prej vitit 2008, pasi i kam dhënë kunatit tim A.B. një shumë prej 7.500 euro. Me kontratën që Ju citoni, blerës ka qenë kunati im, A.B. dhe jo unë. Për sa i përket kronologjisë së veprimeve që Ju citoni, ku referuar tyre u ka rezultuar se data e lidhjes së kontratës ka qenë data 03.01.2009, dhe jo data 03.01.2008, deklaroj se unë nuk kam qenë as në rolin e palës blerëse, as në rolin e palës shitëse. Këto dokumenta nuk më përkasin mua, ndaj dhe nuk mund të jap shpjegime për to, apo për gabime materiale që mund të jenë bërë në zyrat noteriale gjatë hartimit të dokumentacionit. Ajo që më përket mua dhe që deklaroj me përgjegjësi, është se mjetin Daimler Chrysler, me targa LA***A, duhet ta kem marrë në zotërim diku nga fundi i vitit 2008 dhe shumën 7500 euro e kam paguar në vitin 2008. Nuk përjashtohet mundësia që ta kem marr në përdorim jo në fund të vitit 2008, po në fillim të vitit 2009, gabim lehtësisht i pranueshëm nisur nga koha e largët e veprimit dhe mos pasjes të asnjë dokumentacioni.*

Kontratën e shitblerjes me kunatin tim A.B e kam bërë më datë 10.06.2013, kohë kur kam ndryshuar targat e mjetit. Duke qenë lidhje miqësore, por dhe fakti se unë punoja larg banesës dhe mjetin kunati e përdorte edhe në shërbim të familjes sime, që ishin në Tiranë (bashkëshortja me fëmijët për nevoja të rastit), nuk e kam bërë më para kontratën e shitblerjes, dhe nga ky fakt nuk ka ardhur asnjë pasojë as për shtetin, as për publikun. Mjeti ka qarkulluar konformë ligjit, duke iu nënshtruar të gjitha detyrimeve fiskale.

❖ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese pranë AMP:**

71. Referuar deklaramenteve të bëra nga subjekti i vlerësimit rezulton se, mjeti tip Autoveturë Mercedes Benz me targa AA***GT është në përdorim nga subjekti i vlerësimit prej vitit 2008 por në vitin 2013, ka lidhur kontratën e shitblerjes nr.*** rep. dhe *** kol. datë 10.06.2013. Në lidhje me këtë fakt subjekti deklaroi se: *Duke qenë lidhje miqësore, por dhe fakti se unë punoja larg banesës dhe mjetin kunati e përdorte edhe në shërbim të familjes sime, që ishin në Tiranë (bashkëshortja me fëmijët për nevoja të rastit), nuk e kam bërë më para kontratën e shitblerjes, dhe nga ky fakt nuk ka ardhur asnjë pasojë as për shtetin, as për publikun.*

Në deklaratën noteriale nr. *** rep. dhe nr. *** kol. datë 03.02.2022, të lëshuar nga A.B., i cili deklaroi se “në vitin 2008 ka blerë një automjet Mercedes Benz me targa LA***A dhe prej atij viti ai ka lënë në përdorim në mirëbesim Ndue Doçit dhe për shkak të marrëdhënieve miqësore nuk kanë nënshkruar kontratë”.

Në Ligjin Nr.8378, datë 22.07.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar në neni 93 “Formalitetet për ndryshimin e pronësisë së automjeteve, motomjeteve dhe rimorkiove dhe për ndryshimin e vendbanimit të pronarit”, pika 1, shprehimisht thuhet se: “Në rast ndryshimi pronësie të mjeteve rrugore ose në rastin kur u jepen në përdorim të tjerëve apo

kur lidhen marrëveshje për qiradhënie me të drejtë blerjeje, personi i interesuar, brenda 30 ditëve nga data kur nënshkrimi i aktit është vërtetuar ose është gjykuar i rregullt, paraqitet pranë degës përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila merr masa për regjistrimin e ndryshimit të pronësisë ose të ndryshimeve të tjera”. Gjë e cila nuk është bërë.

72. Në lidhje me mundësinë financiare për blerjen e automjetit tip Autoveturë Mercedes Benz me targa AA***GT, Trupa Vlerësuese hartoi tabelën e rezultatit financiar e cila në mënyrë të përmbledhur rezulton si më poshtë:

Të ardhura gusht 2002 – dhjetor 2008 gjithsej	3.560.524 lekë
Shpenzime gusht 2002 – dhjetor 2008 gjithsej	2.730.938 lekë
Mundësia për kursim	829.586 lekë
Blerje Automjeti Dhjetor 2008	- 924.000 lekë
Diferenca +/-	- 94.414 lekë

Burimi/Viti	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Të ardhura neto nga paga apo shperblime nga marredheniet e punesimit	103,522	325,178	426,932	428,668	470,477	660,349	511,532
Të ardhura neto nga paga apo shperblime nga marredheniet e punesimit Bashkeshortja nga tetor 2002	24,553	132,594		19,375	120,674	196,380	140,290
Totali i të Ardhurave neto	128,075	457,772	426,932	448,043	591,151	856,729	651,822
Detyrime: Te hyra nga huate/kredi/dhurim							
Shpenzime jetike sipas INSTAT	78,010	218,428	280,836	332,136	332,136	942,912	546,480
Totali i shpenzimeve dhe te dalave	78,010	218,428	280,836	332,136	332,136	942,912	546,480
Investime,ne bono thesari							
Blerje makine							924,000
Depozitë							
Gjendje Cash + ne llogari							
Totali Pasuri	-	-	-	-	-	-	924,000
Mundësia per Kursime : Te Ardhura+Detyrime-Shpenzime-Pasuri.	50,065	289,409	435,505	551,412	810,427	724,244	- 94,414

Në lidhje me balancën negative për blerjen e automjetit tip Autoveturë Mercedes Benz me targa AA***GT Trupa Vlerësuese i është drejtuar subjektit të vlerësimit me email-in e datës 20.11.2023, i cili në përgjigjen e tij të datës 24.11.2023 protokolluar me tonën me nr. *** prot. po të datës 24.11.2023, sqaron se:

Ashtu si edhe kam deklaruar gjatë procesit të vlerësimit, marrëdhëniet e mia të punësimit në Policinë e Shtetit kanë nisur në muajin gusht të vitit 2002 dhe pagën time të parë e kam marrë në muajin gusht të vitit 2002 (më parë unë kam qenë student i Akademisë së Policisë). Duke qenë se të ardhurat e mia nga punësimi kanë nisur në gusht të vitit 2002, atëherë rrjedhimisht edhe shpenzimet e mia duhet të nisin të përlllogariten nga muaji gusht 2002.

- *Për periudhën gusht 2002 - mars 2005, ju lutem referojuni dokumentacionit të të ardhurave të paraqitur nga unë në ILDKPKI, periudhë në të cilën pagat dhe shpërblimet janë marrë në borderotë e institucionit ku kam punuar. Për këtë periudhë të ardhurat neto nga pagat janë në*

shumën 1.053.182 lekë. Më duhet të shtoj që në këtë dokument janë pasqyruar vetëm të dhënat nga pagat neto dhe mungojnë të dhënat për shumat e përfituara nga shpërblimet, taksa e solidaritetit, dietat, orët e natës, orët suplementare, pagesat për pushimet vjetore të pakryera, paga e trembëdhjetë etj, të dhëna të cilat do ta rrisnin edhe shumën e të ardhurave totale. Cilësoj se në përllogaritjen tuaj duhen të vendosen edhe të ardhurat e përfituara nga dietat pasi ato kanë mbuluar shpenzimet e kryera në funksion të shpenzimeve jetike. Në rastin se të ardhurat nga dietat nuk përllogariten në analizën tuaj, atëherë në përllogaritjen tuaj për të pasur një analizë të drejtë, në shpenzimet e mia sipas INSTAT, duhet të zbrisni të njëjtën shumë sa masa e dietës që nuk përllogarisni si të ardhur.

Shpenzimet tona familjare sipas INSTAT për periudhën gusht 2002 - dhjetor 2008 (të miat, b/shortes dhe fëmijëve sipas periudhës që ata kanë lerë, djali S. në muajin shtator 2003 dhe vajza S. në muajin prill 2007 përllogariten në shumën 2.647.866 lekë.

Automjeti tip Mercedes Benz, me targa AA *** GT, në shumën 7.500 euro, ose konvertuar 924.000 lekë, ashtu si edhe ju ka rezultuar gjatë kontrollit, është paguar diku në muajin dhjetor 2008 ose janar 2009.

Në analizën e saj Trupa Vlerësuese e mbështetur në përgjigjen e dhënë nga subjekti vlerësimit si edhe dokumentacionin shtesë të paraqitur rezulton se:

Subjekti i vlerësimit ka paraqitur dokumentacion shtesë përsa i përket të ardhurave të punësimit të bashkëshortes së tij mësuese pranë shkollës 9-vjeçare Fushë Milot, Gurëz dhe Gorre gjatë periudhës nëntor 2001 deri me dhjetor 2003, por edhe përsa i përket të të ardhurave të tij nga shpërblimet dhe paga të tjera shtesë dhënë për shkak të funksionit të tij. Për sa i përket pagesës së djetave për të cilën subjekti pretendon edhe në shpjegimet e tij në bazë të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar neni 8 “E ardhura e Tatueshme” Pika 1. Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme: a) pagat dhe shpërblimet e tjera, në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës.

Për efekt përllogaritjes në tabelën e rezultatit financiar të ardhura për bashkëshorten do të përllogariten nga tetor 2002, kur subjekti deklaroi se është lidhur në martesë, deri më dhjetor 2003, dhe respektivisht në shumën prej 157.147 lekë. Bashkëlidhur subjekti e shoqëron me vërtetimin për marrëdhëniet e punësimit si edhe me ekstrakin bankar shtesë në Raiffeisen Bank me të ardhurat nga shpërblimet dhe orët shtesë, si edhe paga shpërblim për shkak të pozicionit që ka mbajtur për periudhën 2005 - 2008.

Përllogaritjet sipas konsumit mesatar mujor janë llogaritur për frymë. *Të dhënat e marra nga Anketa e Buxhetit të Familjes dhe Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës.*

Përllogaritjet i referohen periudhës nga Gusht 2002 e në vazhdim.

Në mënyrë të përmbledhur referuar tabelës së rezultatit financiar, si edhe dokumentacionit shtesë dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

Të ardhura gusht 2002 – dhjetor 2008 gjithsej	3.560.524 lekë
Shpenzime gusht 2002 – dhjetor 2008 gjithsej	2.730.938 lekë
Mundësia për kursim	829.586 lekë
Blerje Automjeti Dhjetor 2008	- 924.000 lekë
Diferenca +/-	- 94.414 lekë

- **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur, shpjegimet e dhëna me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR.**
- **Konstatohet pamjaftueshmëri në vlerën prej -94.414 lekë në blerjen e automjetit Autoveturë Mercedes Benz me targa AA *** GT.**

Pasuria 4

73. d. Llogari page në Raiffeisen Bank, me gjendje në dt. 06.03.2023, në vlerën 334.068 lekë.
Zotërimi 100 %. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga, shpërblime, etj.

Bashkëlidhur deklaratës:

- ✓ Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank në emër të Ndue Doçi, me gjendje në datë 27.02.2023, vlerën 334.068 lekë.
 - Raiffeisen Bank. me shkresën nr. *** prot, dt. 08.05.2023, konfirmon se Ndue Doçi, në datë 06.03.2023 ka llogari page me gjendje 450.759 lekë.
 - Në proces-verbalin e datës 19.07.2023, subjekti shpjegoi se gjendja e llogarisë ka ndryshuar si rrjedhojë e kreditimit të pagës së muajit shkurt në fillim të muajit mars, gjë që ka sjell edhe ndryshimin e gjendjes së llogarisë nga 334.068 lekë, në 450.759 lekë,
 - ✓ Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me deklarinimin. Ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka ka ardhur për shkak të paraqitjes së tyre në data të ndryshme dhe konkretisht deklarimi i përket datës 27.02.2023, ndërsa kërkesa dhe konfirmimi i bankës i përket datës 06.03.2023.
- ❖ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese pranë AMP.**

74. Trupa konstaton se ndryshimi midis gjendjes së deklaruar dhe asaj të konfirmuar nga banka, ka ardhur për shkak të paraqitjes së tyre në data të ndryshme dhe konkretisht, deklarimi i përket datës 27.02.2023, ndërsa kërkesa dhe konfirmimi i bankës i përket datës 06.03.2023

Trupa arrin në përfundim se:

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur, shpjegimet e dhëna si edhe përgjigjen nga Raiffeisen Bank sha. me shkresën nr.*** prot, datë 08.05.2023.**
75. Bono Thesari në Raiffeisen Bank me gjendje në dt. 06.03.2023, në vlerën 1.700.000 lekë.
Zotërimi 100 %. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga, shpërblime, etj.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nga Raiffeisen Bank për Bono Thesari në emër të Ndue Doçi, me gjendje në datë 27.02.2023, në vlerën 1.300.000 lekë dhe 400.000 lekë. Raiffeisen Bank me postën elektronike të datës 08.06.2023, konfirmon se, Ndue Doçi ka Bono Thesari me afat 06.10.2022 - 05.10.2023, në shumën 1.300.000 lekë dhe 400.000 lekë, për shumën totale 1.700.000 lekë.
- Nga të dhënat e Raiffeisen Bank rezulton se, fillimisht në datë 30.09.2021 janë blerë Bono Thesari për vlerën 1.000.000 lekë dhe pas maturimit të tyre, në datë 06.10.2022, janë blerë Bonot e Thesarit për vlerën 1.300.000 lekë dhe 400.000 lekë.
- Subjekti ka blerë Bono Thesari me vlerë 1.000.000 lekë, në vitin 2021 dhe ka shtuar me 700.000 lekë në vitin 2022.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank.

Fond Investimi në Raiffeisen Invest, me gjendje në dt. 06.03.2023, në vlerën 154.470 lekë. Zotërimi 100%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga, shpërblime, etj.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Pasqyrë llogarie nga Raiffeisen Bank për Fond Investimi në emër të Ndue Doçi, me gjendje në datë 24.02.2023, në vlerën 154.470 lekë.
- Raiffeisen Invest me shkresën nr. *** prot, dt. 12.05.2023, konfirmon se Ndue Doçi, në datë 06.03.2023 ka fond investimi me gjendje 154.795 lekë. Ky fond investimi është çelur në datë 11.10.2021, dhe në të kryen blerje mujore prej 30.000 lekë (në 07.10.2022, ka pasur një tërheqje nga fondi në shumën 349.613 lekë).

❖ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese pranë AMP**

76. Me shkresën nr. *** prot, dt. 12.05.2023, të Raiffeisen Invest konfirmon se Ndue Doçi, në datë 06.03.2023, ka fond investimi me gjendje 154.795 lekë. Ky fond investimi është çelur në datë 11.10.2021, dhe në të kryen blerje mujore prej 30.000 lekë në 07.10.2022 ka pasur një tërheqje nga fondi në shumën 349.613 lekë.

✓ **Konfirmohet deklarimit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Invest.**

77. DEKLARIMI I ARDHURAVE

• Të ardhura nga funksionet në Policinë e Shtetit për periudhën gusht 2002 - shkurt 2023. Shuma 17.305.587 lekë.

• Të ardhura nga shitja e pjesës takuese të banesës 1- kat në "Don Bosko", Tiranë në vitin 2012. Shuma 3.500.000 lekë.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vërtetim nr.*** prot, dt. 02.03.2023, lëshuar nga Akademia e Sigurisë, ku vërtetohet se Ndue Doçi, për periudhën 09.10.2013 - 06.02.2014 dhe 25.08.2016 - 29.09.2017, ka përfituar të ardhura neto në shumën 1.383.132 lekë.

- Vërtetim nr.*** prot, dt.06.10.2020, lëshuar nga Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin Vlorë, për të ardhurat e Ndue Doçi, për periudhën maj 2008 - dhjetor 2009, ku ka përfituar të ardhura në shumën 342.496 lekë.

78. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot, dt. 08.05.2023, në llogarinë e pagës së Ndue Doçit, ku evidentohet se për periudhën 04.05.2005 -01.08.2008; 02.11.2010 - 23.12.2010 dhe 05.04.2011 - 06.03.2023 ka përfituar të ardhura nga paga, shpërblime, dieta, etj., në shumën 16.517.996 lekë.

79. Tirana Bank me shkresën nr. *** prot, dt. 12.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie të pagës së Ndue Doçit, ku evidentohet se për periudhën 06.01.2011 - 08.04.2011, ka përfituar të ardhura nga paga dhe shpërblime në shumën 278.048 lekë.

80. Fibank me shkresën nr. *** prot, dt. 08.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie të pagës së Ndue Doçit, ku evidentohet se për periudhën 01.09.2008 - 20.10.2010, ka përfituar të ardhura nga paga dhe shpërblime në shumën 2.084.133 lekë.

81. ISSH me shkresën nr. *** prot, dt. 10.05.2023, nga viti 2012 që ka të dhëna, konfirmon se Ndue Doçi për periudhën tetor 2012 - mars 2023, ka qenë i punësuar pranë: Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastrë; Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë; Qendra e Formimit Policor Tiranë; Policia Kufitare dhe Emigracionit; Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Emigracionit/Migracionit; Akademia e Sigurisë; dhe Departamenti për Kufirin dhe Migracionin.

❖ **Hetimi kryer nga Trupa Vlerësuese pranë AMP:**

82. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot, dt. 08.05.2023, dhe me shkresën nr. *** prot datë 14.09.2023 të Raiffeisen Bank bashkëlidhur CD-në, me llogarinë e pagës së Ndue Doçit, ku evidentohet se për periudhën 04.05.2005 - 01.08.2008; 02.11.2010 - 23.12.2010 dhe 05.04.2011 - 06.03.2023, ka përfituar të ardhura nga paga, shpërblime, dieta, etj, në shumën 16.517.996 lekë.

83. Tirana Bank me shkresën nr. *** prot, dt. 12.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie të pagës së Ndue Doçit, ku evidentohet se për periudhën 06.01.2011 - 08.04.2011, ka përfituar të ardhura nga paga dhe shpërblime në shumën 278.048 lekë.

84. Fibank me shkresën nr. *** prot, dt. 08.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie të pagës së Ndue Doçit, ku evidentohet se për periudhën 01.09.2008 - 20.10.2010, ka përfituar të ardhura nga paga dhe shpërblime në shumën 2.084.133 lekë.

85. ISSH me shkresën nr. *** prot, dt. 10.05.2023, nga viti 2012 që ka të dhëna, konfirmon se Ndue Doçi, për periudhën tetor 2012 - mars 2023, ka qenë i punësuar pranë: Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastrë; Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë; Qendra e Formimit Policor Tiranë; Policia Kufitare dhe Emigracionit; Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Emigracionit/Migracionit; Akademia e Sigurisë; dhe Departamenti për Kufirin dhe Migracionin.

86. Subjekti ka deklaruar edhe të ardhura nga puna e tij në emigracion në vitet 1992-1994, pa dokumentacion. Ka bërë punë të ndryshme si në bujqësi, në ndërtim e punë të tjera të ndryshme sipas rastit. Subjekti merrte një shpërblim për punën e bërë rreth 5000 dhrahmi ose afërsisht rreth 25 dollar në ditë. Nga puna në emigrim subjekti pretendon se ka fituar rreth 1.000.000 dhrahmi ose rreth 5000 dollarë. Transportimi i vlerave monetare nga shteti Grek në Shqipëri është bërë dorazi pa dokumentacion. Po kështu subjekti pas kthimit nga emigracioni ka punuar në kompaninë e djalit të xhaxhait të tij “***” shpk.

Nisur nga ky fakt Trupa Vlerësuese e ka të pa mundur justifikimin e shumës prej 5.000 dollarë pasi nuk disponohet as edhe një dokumentacion justifikues dhe si të tillë nuk e përfshin në rezultatin financiar.

Por rrjedhimisht është i aplikueshëm neni 32, pika 1.1 e ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit. Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur, shpjegimet e dhëna me përgjigjen e ardhur nga bankat për të ardhurat e deklaruara nga pagat.**

DETYRIME FINANCIARE

87. Detyrim ndaj shitësit të apartamentit në Rr. "****", Tiranë, shtetasit D.D., në shumën 2.500.000 lekë. Trajtuar më sipër.

88. SHPENZIMET E DEKLARUESHME

Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet. si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur.

Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.

- Shpenzime uji për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022. Shuma 10.330 lekë.
- Shpenzime energji elektrike për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022. Shuma 78.446 lekë.
- Shpenzime telefonie për dy numrat e celularit për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022. Shuma 12.870 lekë.
- Shpenzime telefonie për numrin e celularit të b/shortes për periudhën 01.01.2022 -31.12.2022. Shuma 12.600 lekë.
- Shpenzime interneti për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022. Shuma 17.880 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- a. Librezë e OSHEE në emër të Ndue Doçi, me kontratë nr. 543****, për pagesat e kryera për periudhën janar - dhjetor 2022, në shumën rreth 78.500 lekë.
 - b. Librezë e OSHEE në emër të L. Doçi, me kontratë nr. 0035****, për pagesat e kryera për periudhën janar - dhjetor 2022, në shumën 10.256 lekë.
 - c. E-mail nga Vodafone, datë 03.02.2023, për Ndue Doçi, ku informohet për faturat e abonentit për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, në shumën 6.870 lekë.
 - d. E-mail nga Vodafone, datë 01.03.2023, për Ndue Doçi, ku informohet për faturat e abonentit për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, në shumën 7.996 lekë.
 - e. Fatura celulari (të b/shortes), për periudhën janar - dhjetor 2022, në shumën 12.559 lekë.
- ✓ UKT Tiranë me shkresën nr. **** prot, dt. 18.05.2023, nuk konfirmojnë kontratë të lidhur në emër të subjektit ose personave të lidhur.
 - ✓ 14 shoqëri të tjera Rajonale të UK., nuk konfirmojnë kontratë të lidhur në emër të subjektit ose personave të lidhur.
 - ✓ FSHU me shkresën nr. *** prot, dt. 18.05.2023, konfirmon se në emër të Ndue Mark Doçi, me ID H1051****A, identifikohet 1 abonent me kontratë të furnizimit në instancën Tiranë, në Rr. "****", Tiranë, me kontratë nr. 543****, ku për periudhën shkurt - dhjetor 2022, ka paguar në total 70.192 lekë. Gjithashtu konfirmon se në emër të L. Doçi, me ID H8521****S, identifikohet 1 abonent me kontratë të furnizimit në instancën Tiranë, në Rr. "****", Tiranë, me kontratë 0035****, ku për periudhën janar - dhjetor 2022, ka paguar në total 10.250 lekë.
 - ✓ FSHU konfirmon gjithashtu se me gjeneralitetet: Ndue Doçi, identifikohen 5 abonentë, 3 në Burrel dhe 2 në Lezhë.

- ✓ Vodafone sh.a. me shkresën nr.*** prot, dt.12.06.2023, ka bashkëlidhur me CD, informacion për numrin e celularit në emër të Ndue Doçi, ku për vitin 2022 janë paguar 6.675 lekë, ndërsa në emër të L. Doçi për vitin 2022, janë paguar 12.509 lekë.
- ✓ Albanian Satellite Communications sh.p.k., me shkresën nr.*** prot, dt.15.05.2023, konfirmon se L. Doçi ka kontratë të lidhur më datë 16.04.2019, me tarifë mujore prej 1.490 lekë, ku për vitin 2022, janë kryer në total 11 pagesa, në shumën 16.390 lekë.

Me inventarin nr.extra prot. datë 10.07.2023, subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

Sqarime me shkrim ku shpjegon se kontrata me UK Tiranë për apartamentin ku jeton në Rr. "****", në Tiranë, me nr. 190***-1, është në emër të shtetasit D.D. (djali i xhaxhait) sepse akoma nuk është bërë ndryshimi i kontratës në emrin e tij. Tani që ka dalë çertifikata e pronësisë (së apartamentit) subjekti sqaroi se do të kryejë edhe ndryshimin e kontratës me UKT. Për kontratat e lidhura me FSHU, sqaroi se në emrin e tij është lidhur kontrata për apartamentin ku banon, ndërsa kontrata me nr. 0035*** në emrin b/shortes L. Doçi, është kontrata e lidhur nga b/shortja, për matësin e energjisë elektrike të vendosur tek biznesi që ajo administron. Me FSHU nuk ka kontratë tjetër të lidhur përveç atyre që ka deklaruar. Për sqarimin e kësaj shtate, i është drejtuar me një kërkesë Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe është në pritje të përgjigjes për sqarimin përfundimtar.

Paraqiti:

- Kërkesë postare dt. 20.06.2023, nga Ndue Doçi, drejtuar FSHU-së, me anë të së cilës kërkon numrat e kontratave që ka të lidhura me këtë institucion. Pa përgjigje deri në momentin e dërgimit të relacionit.
 - Librezë e UK, nr. 190***-1, në emër të D.D, ku për periudhën janar - dhjetor 2022, janë paguar gjithësej rreth 26.299 lekë.
89. Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se: Kontrata për furnizimin me ujë për apartamentin ku jeton subjekti, rezulton e lidhur ende në emër të pronarit të mëparshëm, D. D. Subjekti dhe b/shortja e tij kanë lidhur dy kontrata për furnizimin me energji elektrike, një kontratë i përket apartamentit ku jetojnë dhe kontrata tjetër i përket aktivitetit privat të b/shortes.
- ✓ **Konfirmohet shpjegimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e FSHU. Për kontratat e tjera të konfirmuara nga FSHU, subjekti dha sqarime ku deklaroi se këto kontrata nuk i përkasin atij.**
 - ✓ Shpenzimet e deklaruara për ujë, drita, telefoni, internet, gjatë periudhës së sipërcituar, me kontrata në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të, rezultojnë në total rreth 150.000 lekë.
90. Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendrike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara
- Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022

- Shpenzime për udhëtimet private për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2022, nuk kam pasur udhëtime private jashtë vendit gjatë 3 viteve të fundit.

Bashkëlidhur deklaratës:

- ✓ Të dhëna nga sistemi TIMS për Ndue Doçi, ku për periudhën pas datës 01.01.2019, rezulton se ka kryer 6 dalje dhe 6 hyrje nga pikat kufitare, Kapshticë, Kakavijë dhe Morinë.
- ✓ Të dhëna nga sistemi TIMS për L. Doçi, ku për periudhën pas datës 01.01.2019, rezulton se ka kryer 3 dalje dhe 2 hyrje nga pikat kufitare, Kapshticë, Kakavijë dhe Morinë.
- ✓ Të dhëna nga sistemi TIMS për S. Doçi, ku për periudhën pas datës 01.01.2019, rezulton se ka kryer 4 dalje dhe 4 hyrje nga pikat kufitare, Kapshticë, Kakavijë dhe Morinë.
- ✓ Të dhëna nga sistemi TIMS për S. Doçi, ku për periudhën pas datës 01.01.2019, rezulton se ka 2 dalje dhe 2 hyrje nga pika kufitare e Kakavijës.

➤ Me inventarin nr.extra prot. datë 10.07.2023. subjekti ka dorëzuar në LDKPK Sqarime me shkrim ku shpjegon se gjatë periudhës 01.01.2019 - 31.12.2022, vetë subjekti nuk ka bërë asnjë udhëtim privat, por ka kryer gjithsej 5 udhëtime për arsye shërbimi. Për të gjitha udhëtimet ka një urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Më datat 06.02.2019 dhe 22.05.2019 ka udhëtuar në Mal të Zi, me automjetet me targa AA *** VF dhe MB *** AA. Më datë 24.04.2022 me Austrian Airlines në Çeki. Më datat 06.05.2022 dhe 22.06.2022 ka udhëtuar me traget në Bari, Itali, për takime periodike me palën italiane. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, për udhëtimet e bëra gjatë periudhës në fjalë, janë mbuluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Bashkëshortja L. Doçi, nga data 01.01.2019 - 31.12.2022, ka dy hyrje - dalje nga Republika e Shqipërisë për në shtetin Grek, në datë 26.06.2019 dhe 10.09.2019 dhe një hyrje-dalje në Morinë për në Kosovë, më datë 11.01.2020.

Në të dy rastet e udhëtimit për në Greqi, ka udhëtuar me automjetin fugon me targa AA*** RJ, dhe ka shkuar tek motra e saj për vizitë familjare. Ndërsa udhëtimin për në Kosovë e ka bërë me vëllain e saj A.B, me automjetin e tij me targa LA *** A.

Në të dy rastet e udhëtimit për në Greqi, shpenzimet e akomodimit, fjetjes dhe biletat e udhëtimit janë mbuluar nga motra e saj M. P. dhe b/shorti i M.P, E. P, shpenzime këto modeste. Ndërsa udhëtimin e datës 11.01.2020, për në Kosovë, shpenzimet janë mbuluar nga vëllai i saj A. B. dhe ka qenë udhëtim ditor vajtje - ardhje, me automjetin e tij personal.

Vajza S. Doçi për periudhën 01.01.2019 deri më 31.12.2022, ka udhëtuar katër herë jashtë Republikës së Shqipërisë.

Më datë 17.04.2019 ka udhëtuar me autobus (eskursion me shkollën) në Greqi, shpenzimet janë mbuluar nga familja shuma e paguar ishte 15.000 lekë, por nuk disponon dokument për këtë rast. Më datë 26.06.2019 dhe 10.09.2019, ka udhëtuar me fugonin me targa AA *** PU, së bashku me nënën e saj, L. Doçi për tek tezja në Greqi. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit janë mbuluar nga tezja dhe b/shorti i tezes.

Më datë 11.01.2020 ka udhëtuar për në Kosovë me nënën, L. Doçi dhe dajën, A.B. me mjetin me targa LA *** A, në pronësi të tij vajtje - ardhje brenda ditës.

Shpenzimet ditore të udhëtimit janë mbuluar nga daja i saj.

Djali S. Doçi për periudhën 01.01.2019 deri më datë 31.12.2022 ka udhëtuar dy herë jashtë Republikës së Shqipërisë. Më datë 26.06.2019 dhe 10.09.2019, për në Greqi, së bashku me nënën, L. Doçi dhe motrën, S. Doçi për tek tezja e vet.

Udhëtimi është me mjetin fugon me targa AA *** RJ.

Shpenzimet e udhëtimit në të dy rastet janë mbuluar nga tezja dhe b/shorti i saj.

Të dhëna nga TIMS për Ndue Doçi, L. Doçi, S. Doçi dhe S. Doçi.

- Kopje pasaporte greke në emër të shtetasit E.P.
- Kopje ID greke në emër të shtetases M.P.
- Deklaratë nga E. P. në të cilën citohet se në datat 10.09.2019 dhe 26.06.2019, shtetasit L.S. dhe S. Doçi kanë udhëtuar në Greqi dhe transportimi, akomodimi dhe çdo gjë tjetër për ditët e qëndrimit janë paguar prej tij.
- Kopje pasaporte shqiptare në emër të shtetasit A.B.
Sqarime me shkrim ku shpjegon se shpenzimet e udhëtimeve në Greqi për b/shorten dhe fëmijët janë mbuluar nga motra e b/shortes që jeton në Greqi. Për udhëtimet në Greqi të kyera nga familjarë, subjekti sqaroi se b/shortja dhe fëmijët kanë paguar vetëm për biletën e transportit që kanë kushtuar rreth 50 euro për person. Bashkëshortja dhe fëmijët kanë qëndruar në banesën e motrës dhe nuk kanë pasur shpenzime. Për udhëtimin e b/shortes me vëllain e saj në Kosovë, nuk ka pasur shpenzime pasi udhëtimi ka qenë vajtje - ardhje dhe për shkak të një fatkeqësie.

❖ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese pranë AMP:**

91. Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezultojnë se:

Për periudhën 2019 - 2022, subjekti nuk ka pasur udhëtime private jashtë vendit.

Për udhëtimet private të familjarëve në Greqi dhe Kosovë, subjekti deklaroi se ato kanë qenë modeste ku janë paguar vetëm shpenzimet e transportit.

Shpenzimet e deklaruara për udhëtime private jashtë vendit gjatë periudhës së sipërcituar, në emër personave të lidhur me të, i përkasin vitit 2019.

Për periudhën 2020 - 2022, subjekti deklaroi se jashtë vendit ka udhëtuar vetëm 1 herë b/shortja me vajzën e tij në një udhëtim 1 ditor në Maqedoni, shpenzimet të mbuluara nga vëllai i b/shortes.

✓ **Konfirmohet deklarimit me dokumentacionin e dorëzuar dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i vlerësimit.**

92. Për arsimin e fëmijëve madhorë apo të mitur apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit të vlerësimit “*Periudha nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.*”

▪ Djali S. Doçi, për gjatë periudhës arsimore nga shkolla fillore dhe aktualisht, në vitin e I-rë në Universitetin ”****”, ka pasur shpenzime shkollore vetëm në Universitetin ”****”, në shumën

4.000 euro. Për vitet e arsimit nga shkolla fillore deri në përfundim të gjimnazit, ka qenë në arsimin publik pa pagesë. Trajtuar më poshtë.

- Vajza S. Doçi, për gjatë periudhës arsimore, nga shkolla fillore deri aktualisht, në vitin e I-rë, në gjimnazin “***”, ka qenë dhe është në arsimin publik, pa pagesë.

93. Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim dt. 28.02.2023, lëshuar nga gjimnazi “***”, ku vërtetohet se S. Doçi, në Vitin shkollor 2022 - 2023, është nxënëse e klasës së X-të.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur.**

94. TË DHËNA KONFIDENCIALE

Në vitin 2012, një miku im i quajtur B.B, më ka propozuar blerjen e një automjeti Mercedes Benz (me targa AA *** AG), të cilin ai e kishte gjetur me një çmim të mirë okazoni. Këtë automjet pasi e bleva për çmimin 500.000 lekë e kam çuar për ta kontrolluar në servis, ku ka rezultuar se automjeti ka pasur shasinë e deformuar. Nisur nga kjo situatë, duke qenë se tashmë unë automjetin e kisha blerë, por s'mund ta përdorja për defektin që kishte, miku që më propozoi blerjen e mjetit u tregua i disponueshëm për ta marrë ai mjetin, duke më paguar lekët nga vetja e vetë. Këtë automjet miku im B.B.e ka pasur në përdorim deri në vitin 2013 kur ai vendosi ta shiste. Kontrata e shitblerjes është lidhur mes meje dhe blerëses pasi deri në vitin 2013, automjeti ka qenë i regjistruar në emrin tim, pavarësisht se de facto unë e kisha shitur në vitin 2012 dhe në përdorim e ka pasur miku im.

Burimi financiar i blerjes së automjetit prej 500.000 lekë, kanë qenë kursimet familjare. Dokument noterial: nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 27.02.2023.

Bashkëlidhur deklaratës:

- ✓ Deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 27.02.2023, lëshuar nga B. B, i cili deklaron se në vitin 2012 i ka rekomanduar mikut të tij, Ndue Doçi blerjen e automjetit Mercedes Benz, me targa AA *** AG, sepse shitej me çmimin 500.000 lekë. Pasi u nënshkrua kontrata e blerjes, gjatë kontrollit në servis, rezultoi se mjeti ishte me shasi të deformuar. Në këto kushte i ka propozuar mikut të tij, Ndue Doçi që mjetin ta mbajë vetë ai (B.B.) dhe t'i paguante vlerën 500.000 lekë. Këtë automjet e ka mbajtur në përdorim deri në Vitin 2013, kur e ka shitur. Kontrata është lidhur mes Ndue Doçit, pavarësisht se defacto që në vitin 2012, automjeti është përdorur prej tij (B. B.).

DPSHTRR me shkresën nr.*** prot, dt. 22.05.2023, konfirmon se Ndue Doçi ka pasur të regjistruar në pronësi automjetin me targa AA***GU. Bashkëlidhur:

95. Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 18.04.2012, për automjet Daimler Chrysler, me targa AA *** AG. Blerës: Ndue Doçi. Shitës: K. dhe L. Jushi. Çmimi: 500.000 lekë i likuiduar. Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 20.09.2013, për automjet Daimler Chrysler, me targa AA *** AG Shitës: Ndue Doçi. Blerës: V. D. Çmimi: 500.000 lekë i likuiduar.

96. Me inventarin nr.extra prot., datë 10.07.2023. subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

Sqarime me shkrim, ku shpjegon se shtetasin B. B. e ka mik familje. Ai është kushëri i bashkëshortes dhe ishte ndërmjetës për blerjen e mjetit me targa AA *** AG. Meqënëse pas kontrollit autoteknik, mjeti doli me defekt dhe subjekti nuk e mbajti, ata ranë dakord që mjetin ta mbante B.B. meqënëse ishte ai ndërmjetësi. Aktin e shitblerjes me B.B. nuk u bë nisur nga mirëbesimi me njëri-tjetrin, për të evituar shpenzimet e kontratave noteriale dhe duke qenë se nga B.B. iu premtua se mjeti do të shitej shumë shpejt prej tij.

97. Me postën elektronike të datës 27.07.2023, subjekti ka shpjeguar në ILDKPKI: se lidhur me shitjen dhe blerjen e këtij automjeti, veprimet i ka bërë brenda vitit 2012. Në vitin 2013 ka lidhur formalisht vetëm kontratën e shitjes së mjetit, por shitjen e tij dhe shumën prej 500.000 lekë i kishte marrë qysh në vitin 2012, kur dorëzoi mjetin te shtetasi B.B. Duke qenë që edhe blerja e automjetit, pagesa e shumës prej 500.000 lekë, heqja dorë më pas prej mjetit dhe marrja përsëri e shumës 500.000 lekë, i ka kryer brenda vitit 2012, ka konsideruar se nuk ka pasur më interesa privatë që të deklaronte.

Trupa Vlerësuese konstaton se, subjekti i vlerësimit z. Ndue Doçi si në rastin e parë të posedimit të automjetit Daimler Chrysler me targa LA***A më 03.01.2009, kontratën e shitblerjes me vlerë 7.500 euro e ka bërë më 10.06.2013. Mjetin e dytë Mercedes Benx me targa AA***AG me vlerë 500.000 lekë të blerë nga subjekti në vitin 2012, edhe pse deklarohet se nuk është përdorur prej tij, por nga kunati i tij mjeti rezulton i targuar në emër të subjektit z. Doçi deri me 20.09.2013. Po kështu sipas deklaramit të subjektit pjesën takuese të shtëpisë së banimit ia ka shitur vëllait Z.D, në vitin 2012, nuk kanë bërë në atë kohë kontratë shitblerje, pasi ishte marrëdhënie vëllazërore dhe nuk ishte e nevojshme për kontratë noteriale.

98. Në seancën dëgjimore, anëtarja e trupës së vlerësimit z. Denisa Sina ju drejtua subjektit të vlerësimit me pyetjen se: Në deklaratën e pasurisë ju keni deklaruar makinë tip Autoveturë Mercedes Benz, me targa AA *** GT, me vlerë 7500 euro të përfituar me kontratën nr.*** rep, *** kol datë 10.06.2013, ndërkohë që e ka marrë në përdorim në vitin 2008. Ju lutem jepni sqarime me çfarë dokumenti e keni përdorur këtë mjet nga viti 2008-2013 dhe nëse dispononi, ju lutem ta paraqisni pranë sekretariatit teknik.

Subjekti në përgjigjen e tij u shpres se: *Duke qenë lidhje miqësore, por dhe fakti se unë punoja larg banesës dhe mjetin kunati im (vëllai i bashkëshortes) e përdorte edhe në shërbim të familjes sime, nuk kemi bërë as kontratë - shitje dhe as akt- përdorimi, për mjetin në fjalë.*

Konkluzion: Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacionin e duhur lidhur me blerjen dhe shitjen e automjetit Daimler Chrysler, me targa AA*AG (sot AA***GU).**

99. Nga korespondenca me noter J. B. me seli në Durrës, rezulton se është hartuar kontrata qiraje me nr.*** rep. dhe *** kol. datë 21.08.2019 me një afat dy vjecar, ndërmjet shoqërisë “****” grup shpk dhe z. Ndue Doçi me qëllim banimi dhe me vlerë mujore 10.000 lekë. Në lidhje me këtë subjektin i është kërkuar që të japi shpjegimet e duhura dhe të paraqesi dokumentacionin e nevojshëm.

Në kthim përgjigjen e tij protokolluar me tonën nr. *** prot datë 10.11.2023, subjekti sqaron se: *Nisur nga natyra e punës së Policisë dhe fakti që, në atë periudhë në ambjentet e DVKM Durrës nuk kishte një ambjent për të fjetur, ishte e domosdoshme sigurimi i një ambjenti pushimi për ditë të caktuara. Mundësinë për të ardhur në banesë çdo natë nuk e kisha, nga ngarkesa në punë. Ndaj kam marr një dhomë me qera, të cilën e kam përdorur deri në tetor të vitit 2020. Afërsisht 14 muaj, kundrejt një shume 10.000 lekë në muaj. Meqënëse në DVKM u rregullua një ambjent pushimi, i cili ekziston dhe sot, kontrata në fjalë është ndërprerë. Dua të theksoje se adresa ime e banimit nuk ka ndryshuar, ka qenë po ajo e deklaruar në fillim. Nuk ishte adresa ime e banimit, por ishte vendi në funksion të ushtrimit të detyrës ku herë pas here isha i detyruar të qëndroja, deri në momentin e adoptimit të një ambienti brenda DVKM Durrës. Vlera e shpenzuar për këtë marrëdhënie qeraje është poshtë vlerës që ligji më detyronte të deklaroja si shpenzim në DPV 2019.*

❖ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese pranë AMP.**

Subjekti i vlerësimit z. Ndue Doçi ka lidhur një kontratë qeraje me shoqërinë "****" Grup shpk me nr. *** rep. dhe *** kol. datë 21.08.2019, kontratë e cila është revokuar (zgjidhur) më datë 26.10.2020 sipas "Revokim Aktesh të Tjera" nr.***rep. dhe ***kol. datë 26.10.2020. Subjekti në shpjegimet e tij deklaroi se këtë objekt (dhomë) e ka marrë me qera për shkak se ishte e pamundur që të vinte çdo natë në shtëpi për shkak edhe të problematikave të punës së tij dhe të pamundësisë së institucionit për ti suguruar një ambient banimi dhe fjetjeje. Subjekti deklaroi me përgjegjësi se adresa e banimit nuk ka ndryshuar, ka qenë po ajo e deklaruar në fillim.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe shpjegimet e dhëna.**

100. Subjekti i vlerësimit z. Ndue Doçi ka dhënë sqarime me shkrim ku shpjegon se shtetasi P. Xh. (që ka depozituar shumën 4.000 euro në bankë) është punonjës i kompanisë "****" sh.p.k, i cili ka bërë derdhjen e shumës 4.000 euro, në emër të djalit të xhaxhait të subjektit, D.D, me përshkrimin "S. Doçi tarifë shkollimi", me përfitues "Turgut Ozal Education" sh a. Sipas edhe deklaratës noteriale nr.*** rep. dhe ***kol. datë 27.02.2023. Kopje pasaporte shqiptare në emër të shtetasit P. Xh.

101. Me e-mailin e datës 02.11.2023, në pyetësin shtesë Trupa Vlerësuese i ka kërkuar subjektit të vlerësimit që të japë shpjegime dhe paraqesë dokumentacion të punësimit të këtij personi nga sigurimet shoqërore në këtë kompani në momentin e derdhjes së shumës prej 4.000 euro. si dhe të sqarojë lidhjen me këtë person.

Subjekti në përgjigjen e tij protokolluar me tonën nr.*** prot. datë 10.11.2023 sqaron se: *shtetasi P. Xh. është punonjës i Kompanisë "****" shpk dhe ka bërë derdhjen e shumës prej 4.000 euro, në bankë, në emër të djalit të xhaxhait tim D.D. me përshkrimin "S. Doçi tarifë shkollimi" me përfitues "Turgut Ozal Education"sha. Lidhjet e tija me këtë shtetas janë inferiore, nuk i kam patur kurrë subjekt të punës sime as këtë dhe as një pjesëtar të familjes së tij, në asnjë nga qarqet ku kam ushtruar funksionin tim.*

Bashkëlidhur subjekti paraqet edhe dokumentacionin e punësimit nga sigurimet shoqërore të personit P. Nj. Xh. në kompaninë "****" shpk.

Konkluzion i Trupës Vlerësuese:

Bazuar në deklarinë e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, si edhe në korespondencën e subjektit të vlerësimit me Trupën Vlerësuese në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

Djali i subjektit S. Doçi ndjek studimet pranë Universitetit "****". Për studimin, tarifa prej 4.000 euro, është financuar nga shtetasi D.D. (kushëri i subjektit). Si burim financiar të shumës 4.000 euro, subjekti deklaroi se janë të ardhurat nga biznesi i shtetasit D.D.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe shpjegimet e dhëna.**
- ✓ **Shpjegimet dhe dokumentacioni i mundësisë financiare të shtetasit D.D. janë evidentuar më lart.**

102. DEKLARIMI I BASHKËSHORTES – L. DOÇI

Person fizik "L.D.", me Nipt: M0201***C, në adresën Rr. "****", Tiranë, në pasurinë me nr. 7/***, zk. ***. Vlera 0 lekë. Zotërimi 100%. Regjistruar në datë 17.08.2020. Fusha e veprimtarisë: "Rrobaqepësi, riparime, qëndistari, etj". Për hapjen e këtij aktiviteti në vitin 2020 kam shpenzuar një shumë prej 726.151 lekë, me burim kursimet familjare ndër vite. Dyqani ku ushtrohet aktiviteti, pasuria me nr.7/***, është marrë me qira. Qiramarrës: P.F. "L.D". Qiradhënës: D.D. Bashkëlidhur deklaratës:

- ✓ Certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë e llojit njësi, me sip. 45,5m², me nr. pasurie 7/***, në pronësi të D.D. + Planimetri.
- ✓ Kartela e pasurisë së paluajtshme për pasurinë e llojit njësi, me sip. 45,5m², me nr. pasurie 7/***, në pronësi të D.D. + Planimetri.
- ✓ Formular i Deklarimit të T.Th.F, për subjektin tregtar P.F "L.D.", me NIPT M0201***C, për vitin 2020, sipas të cilit ka pasur shpenzimet në shumën 726.151 lekë.
- ✓ Certifikatë regjistrimi në QKB për personin e tatueshëm "L.D" me NIPT M0201***C
- ✓ Ekstrakt historik në QKB për personin e tatueshëm "L.D" me NIPT: M0201***C, regjistruar më datë 17.08.2020, me fushë veprimtarie rrobaqepësi, riparime, qëndistari, etj.
- ✓ Vendi i ushtrimit të aktivitetit: Rr."****", nr. pasurie 7/***, Tiranë. Statusi Aktiv.
- ✓ Kontratë qiraje nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 05.08.2020, lidhur mes qiramarrëses, L. Doçi dhe qiradhënësit, D.D. (përfaqësuar me prokurë nga D.D.), për marrjen me qira të pasurisë me nr. 7/***, në Rr. "****", Tiranë. Qiraja: 10.000 lekë/muaj. Ambienti i marrë me qira do të përdoret vetëm për aktivitetin e licencuar.

103. QKB me shkresën nr. *** prot, dt. 09.05.2023, nuk e konfirmon këtë aktivitet në emër të bashkëshortes së subjektit. QKB online, konfirmon dhe ka të regjistruar ekstrakt historik në QKB për personin e tatueshëm "L.D" me NIPT: M0201***C, regjistruar më datë 17.08.2020, me fushë veprimtarie "rrobaqepësi, riparime, qëndistari", etj. Vendi i ushtrimit të aktivitetit: Rr. "****", nr. pasurie 7/***, Tiranë. Statusi Aktiv.

DPT me shkresën nr. *** prot, dt. 11.05.2023, konfirmon se L. Doçi është e regjistruar si tatimpaguese me NIPT: M0201***C, pranë DRT Tiranë prej datës 17.08.2020.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e QKB online dhe DPT.**

Llogari page në Credins Bank, me gjendje në dt. 06.03.2023, në vlerën 4.337 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga e personit fizik "L.D". Zotërimi 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, në emër të L.Doçi, llogari me gjendje në datë 21.02.2023, në vlerën 4.337 lekë.

Credins Bank me shkresën nr. *** prot, dt. 31.05.2023, konfirmon se L.Doçi, në datë 06.03.2023, ka llogari page me gjendje 4.207 lekë.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Credins Bank.**

Llogari rrjedhëse e P.F. në Credins Bank, me gjendje në dt. 06.03.2023, Vlerën 120.491 lekë. Zotërimi 0%.

Bashkëlidhur deklaratës:

✓ Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, në emër të L. Doçi, për llogari me nr. 1649***, me gjendje në datë 21.02.2023, në vlerën 120.491 lekë.

- Credins Bank me shkresën nr. *** prot, dt. 31.05.2023, nuk e konfirmon këtë llogari.
- Credins Bank. me postën elektronike të datës 01.09.2023. konfirmon se llogaria nr. 1649***, i përket personit fizik L.D.

Me postën elektronike të datës 27.07.2023 subjekti ka shpjeguar në ILDKPKI se: *për sa i përket llogarisë së personit fizik të b/shortes, nuk di mbi mënyrën se si Credins Bank i emërton llogaritë e klientëve, por deklaroi se llogaria që b/shortja ka deklaruar në shumën 120.491 lekë, i përket llogarisë së personit fizik të saj.*

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Credins Bank.**

Depozitë në shoqërinë e Kursim Kreditit UniFin, hapur në datë 23.04.2018, me gjendje në dt. 10.03.2023, në vlerën 549.469 lekë. Kjo është depozitë kursimi për fëmijët S. dhe S.. Burimi i krijimit: 470.000 lekë të gjyshit N. B , për nipërit e tij, si dhe 79.469 lekë të ardhura nga interesi i depozitës. Zotërimi 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nr. *** prot, dt. 23.02.2023, lëshuar nga UniFin, i cili vërteton se L. Doçi në datë 23.04.2018, ka çelur depozitë me afat deri në datë 23.02.2023, në shumën 470.000 lekë dhe interesi të përllogaritur bruto deri në datë 23.02.2023, në shumën 79.469 lekë.
- Mandat arkëtimi dt. 23.10.2009, i një shume prej 100.000 lekë nga N. B. në llogarinë e S. Doçi.
- Mandat arkëtimi dt. 16.08.2013, i një shume prej 100.000 lekë nga N. B.
- Ekstrakt i regjistrimit tregtar për personin fizik "N.B." me NIPT: K6780***B, regjistruar në dt. 03.04.2006, me status çregjistruar.

- Vërtetim dt. 06.03.2023, lëshuar nga DRT Lezhë, e cila vërteton se N.B, me NIPT: K6780***B, ka pasur aktivitet në tregtinë e pjesëve të transportit automobilistik, çregjistruar më datë 15.03.2010.
 - Deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 01.03.2022, lëshuar nga N.B, i cili deklaron se nga kursimet e tij nga puna ka depozituar në llogarinë e nipërve S. Doçi dhe S. Doçi, respektivisht nga 200.000 lekë secilit. Këto depozitime kanë qenë në formë dhurate për t'i përdorur kur të mbushin moshën 18 vjeç.
104. ProCredit Bank me shkresën nr. *** prot, dt. 04.05.2023, konfirmon se N.B. ka depozituar në llogarinë e S. dhe S. Doçit, për secilin prej tyre, 100.000 lekë në datë 23.10.2009 dhe 100.000 lekë të tjera në datë 16.08.2013. Depozitat së bashku me interesat janë tërhequr nga L.Doçi, në datë 19.04.2018, në shumën 235.500 lekë për S. Doçin dhe 235.500 lekë për S. Doçin. DPT me shkresën nr. *** prot, dt. 11.05.2023, konfirmon se N. B. është e regjistruar si tatimpagues me NIPT K6780***B pranë DRT Laç, prej datës 03.04.2006. DRT Lezhë me shkresën nr.*** prot, dt. 29.06.2023, konfirmon se shtetasi N.B, rezulton i regjistruar si person fizik, me NIPT K6780***B, sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, nr. ***, dt. 30.03.2006, me aktivitet "Tregtim pjesësh për makina", me adresë Laç dhe është çregjistruar në datën 15.03.2010. Subjekti klasifikohej si biznes i vogël me Tatim të Thjeshtuar mbi Fitimin. Nga verifikimi i të dhënave që disponohen në dosjen e regjistrimit, në sistemin C@TS dhe në sistemin e mëparshëm, rezulton që subjekti ka deklaruar "Formulari i Deklarimit të Qarkullimit të Biznesit të Vogël", për vitin 2006, në vlerën 1.500.000 lekë. Ndërsa për periudhat tatimore 2007, 2008, 2009 dhe 2010, nuk ka qenë i regjistruar për deklarim të të ardhurave vjetore.
105. ISSH, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, me shkresën nr.***prot, dt.17.05.2023, konfirmon se marrëdhëniet e punësimit për shtetasin N.B. dhe D.B. për periudhën e punësimit 1970 -1993.
106. ISSH me shkresën nr. *** prot, dt. 10.05.2023, nga viti 2012 që ka të dhëna, konfirmon se N.B, prej muajit dhjetor 2019, përfiton pension pleqërie me masë mujore aktuale 23.214 lekë, ndërsa D.B, prej muajit nëntor 2015, përfiton pension pleqërie me masë aktuale mujore 17.603 lekë.

Me inventarin nr.extra prot., datë 10.07.2023, subjekti ka dorëzuar në LDKPKI:

Sqarime me shkrim, ku shpjegon se shuma e mësipërme është depozituar nga vjehri N.B. për dy fëmijët S. Doçi dhe S. Doçi. Këto lekë janë të siguruara nga të ardhurat e kursimet e tij ndër vite. Vjehri që nga viti 1991 ka ushtruar aktivitet privat të riparimit të mjeteve motorike në qytetin e Laçit. Nga data 07.04.2006 deri më datë 15.03.2010, ka pasur dhe aktivitet privat të shitjes së pjesëve të këmbimit dhe vajrave të ndryshëm për makina.

Ekstrakt historik i regjistrimit tregtar për personin fizik N.B. me NIPT K6780***B, regjistruar më datë 03.04.2006 dhe çregjistruar më datë 15.03.2010.

Kthim përgjigje nr. *** prot, dt. 22.06.2023, nga DRT Lezhë, ku informon se subjekti N.B. me NIPT K6780***B, i regjistruar sipas Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me nr.

***, dt. 30.03.2006, me aktivitet "Tregtim pjesë për makina" dhe i çregjistruar më datë 15.03.2010, është klasifikuar si biznes i vogël pa TVSH. Nga verifikimi i të dhënave që disponohen në dosjen e regjistrimit, në sistemin C@TS dhe në sistemin e mëparshëm, rezulton që subjekti ka deklaruar "Formular i Deklarimit të Qarkullimit të Biznesit të Vogël", për vitin 2006, në vlerën 1.500.000 lekë. Ndërsa për periudhat tatimore 2007, 2008, 2009 dhe 2010, nuk ka qenë i regjistruar për deklarim të të ardhurave vjetore.

Subjekti dha shpjegime për burimin financiar të vjehrrit N.B, DRT Lezhë për aktivitetin privat të vjehrrit si person fizik, konfirmon qarkullimin për vitin 2006 në shumën 1.500.000 lekë, ndërsa për periudhat tatimore 2007, 2008, 2009 dhe 2010, informon se ky subjekt tregtar nuk ka qenë i regjistruar për deklarim të të ardhurave vjetore.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur, shpjegimet e dhëna dhe përgjigjen e ProCredit Bank.**

107. DEKLARIMI I ARDHURAVE

- Të ardhura për periudhën 2001- 2003, nga punësimi si mësuese pranë shkollës 9-vjeçare Fushë-Milot, Bashkia Kurbin. Shuma 240.480 lekë.
- Të ardhura për periudhën 2005 - 2020, nga punësimi pranë Inspektoratit të Arsimit Parauniversitar, Bashkia Kukës, si dhe të ardhura nga Policia e Shtetit, si kompensim page për b/shortet e papuna të ushtarakëve të transferuar dhe të ardhura nga vendimi i Gjykatës Administrative Tiranë, për largim të padrejtë nga puna (pagesa të kryera në Raiffeisen Bank). Shuma 4.774.547 lekë.
- Të ardhura nga Policia e Shtetit për periudhën 2008 - 2009, si kompensim page për bashkëshortet e papuna të ushtarakëve të transferuar (pagesa të kryera në Fibank). Shuma 342.496 lekë.
- Të ardhura nga paga PF "L.D", për periudhën 17.08.2020 - 10.03.2023 (pagesa të kryera në Raiffeisen Bank dhe Credins Bank). Shuma 712.896 lekë.
- Fitimi nga biznesi PF "L. Doçi", për periudhën 17.08.2020 - 10.03.2023. Shuma 1.109.065 lekë.
- Të ardhura nga interesi i depozitës në shoqërinë e kursim kreditit për periudhën 23.04.2018 - 10.03.2023. Shuma 79.469 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- ✓ Vërtetim nga Raiffeisen Bank, dt. 16.04.2018, për L. Doçin (ku sipas përshkrimit të bërë me shkrim dore) janë pasqyruar të ardhurat për periudhën 2005 - 2018, të përfituara nga Inspektorati i Arsimit, Bashkia Kukës, transferta si b/shorte ushtaraku dhe vendim gjykate, për shumën 3.957.026 lekë.
- ✓ Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, në emër të L. Doçi, për periudhën 05.04.2018 - 04.08.2020, ku evidentohen kreditimet e pagesave në llogarinë e saj.

- ✓ Formular i Deklarimit të T.TH.F, për subjektin tregtar PF L.D, me NIPT: M0201***C, për vitin 2022, sipas të cilit ka pasur fitim në shumën 935.760 lekë.
- ✓ Formular i Deklarimit të TTHF, për subjektin tregtar PF “L.D”, me NIPT: M0201***C për vitin 2021, sipas të cilit ka pasur fitim në shumën 173.305 lekë.
- ✓ Nxjerrje llogarie në Credins Bank, në emër të L. Doçi (PF), për periudhën 03.02.2022 - 20.02.2023, ku evidentohen kreditimet e pagesave në llogarinë e saj.
- ✓ Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, në emër të L. Doçi, për periudhën 17.06.2021 - 19.01.2022, ku evidentohen kreditimet e pagesave në llogarinë e saj.
- ✓ Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, në emër të L. Doçi, për periudhën 15.02.2022 - 20.02.2023, ku evidentohen kreditimet e pagesave në llogarinë e saj.
- ✓ Vendim i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nr. ***, dt. 19.11.2014, i cili ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. ***, dt. 16.10.2014, i cili ka vendosur detyrimin e palës së paditur, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, t’i paguajë palës së paditëse, L. Doçit 15 paga mujore e 15 ditë pune.
- ✓ Vërtetim nr. *** prot, dt. 23.02.2023, lëshuar nga UniFin, i cili vërteton se L. Doçi, në datë 23.04.2018, ka çelur depozitë me afat deri në datë 23.02.2023, në shumën 470.000 lekë dhe interesa të përllogaritur bruto deri në datë 23.02.2023, në shumën 79.469 lekë.
- ✓ Raiffeisen Bank me shkresën nr. *** prot, dt. 08.05.2023, ka bashkëlidhur CD, me llogarinë e pagës së L. Doçit, ku evidentohet se për periudhën 24.08.2005 - 30.09.2005; 02.06.2006 - 07.01.2008; 02.06.2008 - 01.08.2008; 01.10.2010 - 12.03.2014 dhe 06.10.2015 - 02.09.2020; dhe 17.06.2021 - 19.01.2022, ka përfutuar të ardhura nga paga, shpërblime, dieta, etj, në shumën 4.134.060 lekë dhe vendimi i gjykatës në shumën 806.300 lekë.
- ✓ Fibank me shkresën nr. *** prot, dt. 08.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie të pagës së L. Doçit, ku evidentohet se për periudhën 01.09.2008 - 01.09.2010 ka përfutuar të ardhura nga paga në shumën 393.729 lekë.
- ✓ Credins Bank me shkresën nr. *** prot, dt. 31.05.2023, ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie të pagës së L. Doçit, ku evidentohet se në dt. 12.02.2015 ka përfutuar asistencë në shumën 7.606 lekë, ndërsa për periudhën 15.02.2022 - 06.03.2023 ka përfutuar të ardhura nga paga pranë P.F L. Doçi, në shumën 419.556 lekë.
- ✓ ISSH me shkresën nr. *** prot, dt. 10.05.2023, nga viti 2012 që ka të dhëna, konfirmon se L. Doçi, për periudhën tetor 2012 - mars 2023, ka qenë i punësuar dhe ka përfutuar të ardhura pranë: Inspektoratit Shtetëror të Arsimit; SIDI Group; Bashkia Kukës; shoqata “****”; PF L. Doçi; si dhe Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit.
- ✓ DRT Tiranë me shkresën nr.*** prot, dt. 26.06.2023, konfirmon se L.Doçi, rezulton e regjistruar si person fizik me NIPT M0201***C, më datë 17.08.2020, me aktivitet "Endje tekstilësh". Xhiro e deklaruar dhe fitimi i realizuar nga ky subjekt sipas të dhënave të deklaratave të të ardhurave është si vijon:

Viti	Qarkullimi	Fitimi	Humbja	Fitimi pas tatimit
2020			677.720	
2021	440.352	173.305		173.305

2022	1.924014	935716		935.716
------	----------	--------	--	---------

Me inventarin nr.extra prot., datë 10.07.2023. subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI:

- ✓ Të ardhurat e b/shortes nga paga, raporte, interesa, për periudhën 2005 - 2023, janë në shumën rreth 5.034.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat e b/shortes nga vendimi gjyqësor për largim nga puna. janë shumën rreth 633.975 lekë.
- ✓ Të ardhurat e b/shortes nga fitimi i aktivitetit privat si person fizik janë në shumën rreth 1.109.000 lekë.

108. Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti Ndue Doçi ka deklaruar adresën e plotë ku është regjistruar në Gjendjen Civile si dhe adresën e plotë ku banon: Rr. "****", Nd. ****, H. ****, Ap. ****, Njësia Administrative nr. 9, 1016, Tiranë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë personale dt. 28.02.2023, në emër të Ndue Doçi, sipas së cilës vendbanimi i tij është: Rr. "****", Nd. ****, H. ****, Njësia Administrative nr. 9, 1016, Tiranë.

Me postën elektronike të datës 27.07.2023. subjekti ka shpjeguar në ILDKPKI:

Gjatë periudhave që ka ushtruar detyrën si punonjës i Policisë së Shtetit, jashtë qytetit të Tiranës, kam jetuar/banuar në ambientet e Komisariateve dhe Drejtorive të Policisë, ku ka ushtruar detyrat përkatëse. B/shortja, ka punuar në Laç dhe Kukës, në qytetin e Laçit ka punuar deri në vitin 2003, ku ka banuar tek familja e babait të saj, ndërsa gjatë periudhës që ka punuar në Kukës, ka udhëtuar vajtje - ardhje me mjete të ndryshimet transporti, mjete të punonjësve të Policisë së Shtetit, të cilët ishin me shërbim në Kukës, autobuzët e linjave të Kosovës, mjete transporti të Bashkisë Kukës etj

- ✓ **Rezulton se adresa e deklaruar është e njëjta me adresën e vendbanimit sipas Regjistrimit të Gjendjes Civile.**
- ✓ **Subjekti dha shpjegime për vendbanimet e tij dhe të b/shortes gjatë ushtrimit të detyrës jashtë qytetit të Tiranës.**

Në mënyrë të përmbledhur, referuar të dhënave të deklaratës së pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti dhe b/shortja kanë deklaruar deri në datë 06.03.2023, si më poshtë:

1. Apartament në Tiranë, me sip. 114,73 m², blerë në vitin 2012, me çmimin 5.700.000 lekë. Pagar 3.200.000 lekë dhe mbetur detyrim për t'u paguar 2.500.000 lekë. Zotëruar nga subjekti 100%.
2. Shtëpi banimi me sip. 132,9 m² dhe truall me sip. 400 m², ndërtuar në vitin 1994 në Tiranë, në vlerën 400.000 lekë, ndërsa trualli përfituar me proces legalizimi kundrejt vlerës 288.000 lekë dhe 400.000, Bono Privatizimi (e papërfshirë në llogaritje). Shtëpia i është shitur vëllait në vlerën 6.500.000 lekë. Zotëruar nga subjekti 1/2 me vëllain e tij.
3. Shumë monetare e papaguar (e pashlyer nga vëllai për shitjen e shtëpisë), në vlerën 3.000.000 lekë.

4. Autoveturë Mercedes Benz, me targa AA *** GT, në përdorim prej vitin 2008, lidhur kontrata në vitin 2013, me çmimin 7.500 euro. Subjekti 100%.
5. Llogari page në emër të subjektit në Raiffeisen Bank, në vlerën 334.068 lekë.
6. Bono Thesari në emër të subjektit në Raiffeisen Bank, në vlerën 1.700.000 lekë.
7. Fond Investimi në emër të subjektit në Raiffeisen Invest, në vlerën 154.470 lekë.
8. Person Fizik "L. Doçi", me NIPT M0201***C. Vlera 0 lekë.
9. Llogari page në emër të b/shortes në Credins Bank, në vlerën 4.337 lekë.
10. Llogari e personit fizik në emër të b/shortes në Credins Bank, në vlerën 120.491 lekë.
11. Depozitë në emër të b/shortes në UniFin sha, në vlerën 549.469 lekë.
12. Detyrim ndaj shitësit të apartamentit D.D, në shumën 2.500.000 lekë.

Vlera e pasurisë bruto është 11.786.344 lekë + 7.500 euro, e konvertuar rreth 12.648.000 lekë vlerë neto rreth 10.148.000 lekë. Deri në datën e dorëzimit të deklaratës, subjekti ka pasur/deklaruar detyrime për likuidimin e blerjes së apartamentit në shumën 2.500.000 lekë, ndërsa të tretët kanë pasur detyrim ndaj tij shumën 3.000.000 lekë, të cilat janë shlyer në muajt maj dhe qershor 2023, pa u përfshirë në vlerën e pasurisë më lart.

(Konvertuar me kursin e këmbimit të BSH të datës 06.03.2023, ku 1 Euro 114.86 lekë)

109. Banka e Shqipërisë, BKT, ISP Bank, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Union Bank, OTP Bank Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, Landeslease sha. Credins, AK Invest EasyPay shpk, Fondi Besa, NOA sha, IuteCredit, Kredo.al, ONE Communication sha, Abissnet, Digicom konfirmojnë se subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk janë klient të tyre, çka konfirmohet me deklarinimin.
110. ASHK, Zyrat/Drejtoritë Vendore, Bilisht, Librazhd, Korçë, Krujë, Berat, Gjirokastrë, Pogradec, Gramsh, Lushnië, Malësi e Madhe, Mallakastër, Pukë, Kavajë, Kucovë, Elbasan Kolonjë, Has, Durrës, Kukës, Skrapar, Tropojë, Bulqizë, Peqin, Tepelenë, Përmet, Mirditë Mat, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme në emër të subjektit apo personave të lidhur me të.
111. ABI Bank me shkresën nr. *** prot, dt. 08.05.2023, konfirmon se L. Doçi ka qenë kliente vetëm me ID, pra nuk mban llogari pranë bankës. Klienti ka hapur një llogari page në lekë, të cilën e ka mbyllur në datë 13.11.2018.
112. Unioni Financiar me shkresën nr.***prot, dt. 09.05.2023, konfirmon se për periudhën 27.04.2018 - 06.03.2023, janë kryer transaksionet si vijon: Ndue Doçi, ka kryer 1 transaksion në hyrje në shumën 100 USD dhe 1 tjetër në shumën 10.795 lekë. L. Doçi, ka kryer 1 transaksion në hyrje në shumën 223 euro dhe 1 tjetër në shumën 25.730 lekë.
 - Sqarime me shkrim, ku shpjegon se të dy transaksionet e kryera në shumën 100 USD dhe 10.795 lekë, i ka dërguar shoku i tij, I. A, i cili punon dhe jeton në SHBA. Këto shuma, i janë dërguar me rastin e festave të fundvitit. Transaksionet në emër të bashkëshortes janë dërguar nga një mike e familjes, nga shtetasja D. G. e cila jeton dhe punon në Angli.
 - Dokumente identifikimi amerikane në emër të shtetasit I.A.
 - Postë elektronike dërguar I. A, për L. Doçi, në të cilën citohet: "Unë I.A. me banim dhe punë në USA, New York, i kam dërguar 2 herë nga 100 \$ mikut tim Ndue Doçi. Këtë e kam bërë pasi jemi miq shtëpie dhe në shenjë mirënjohje e respekti me rastin e festave të fundvitit.
 - Dokumente identifikimi nga Mbretëria e Bashkuar në emër të shtetasës D. G.

- Postë elektronike dërguar D.N., për L. Doçi, në të cilën citohet: "Unë jam D.G. Jetoj e punoj në Londër në Angli bashkë me familjen time prej shumë vitesh. Zonjës L. Doçi i kam dërguar 2 herë nga 223 euro për fëmijët, si miq të familjes.
- ✓ **Subjekti dhe shpjegime për sa konfirmuar nga Unioni Financiar ku deklaroi se dërgesat janë kryer nga miq të familjes.**
- ✓ **Deklarimi është i saktë dhe shpjegimet e dhëna përputhen me përgjigjet e ardhura.**
- 113. ASHK Drejtoria e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot, dt.12.06.2023, konfirmon se nga verifikimet e kryera në bazën digjitale të të dhënave të vetëdeklarimeve të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK, rezultoi vetëdeklarues Ndue Mark Doçi (nr. *** prot, dt. 21.08.2006, Formular A, Lezhë).
- 114. ASHK Kurbin, me shkresën nr. *** prot, dt. 27.07.2022 në emër të Ndue Mark Doçi, konfirmon të regjistruar pasuri të llojit arë me nr. ***, me sip. 7.950 m2, në Fshat - Laç.
- 115. ASHK online datë 28.07.2023, në emër të L.N.Doçi, konfirmon të regjistruar në b/pronësi me shtetasin A. N. D, pasurinë me nr. 61/***, zk. ***.
- 116. Në ILDKPKI është administruar: Kartelë e pasurisë së paluajtshme dt. 02.07.2015, për pasurinë e llojit arë me nr. ***, me sip. 7.950 m2, në Laç, regjistruar në emër të shtetasit N. M. D, me nr. identifikimi F7092***U.
- Sqarime me shkrim, ku shpjegon se nuk administron asnjë pasuri tjetër, në asnjë vend brenda Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj, veç pasurive që ka deklaruar në deklaratat periodike. Për të qartësuar këtë problem subjekti i ka dërguar kërkesë ASHK-së. Kërkesë postare dt. 20.06.2023, nga Ndue Doçi, drejtuar ASHK-së Tiranë, me anë të së cilës kërkon ti vihen në dispozicion të gjitha pasuritë që disponon, deri në momentin e dorëzimit të relacionit subjekti nuk ka marrë përgjigje.
- Sqarime me shkrim ku shpjegon se nuk disponojnë asnjë pasuri tjetër në Shqipëri apo jashtë shtetit, veç atyre të deklaruara më parë. Janë në dijeni të faktit që është dhe një person tjetër me të njëjtat gjeneralitete dhe atësi me bashkëshorten, me origjinë nga Mirdita.
- Pasuria e llojit arë me sip. 7.950 m2, e konfirmuar në emër të N.M.D, me nr. personal F7092***U, rezultoi se nuk është pasuri e subjektit, pasi nga të dhënat rezultoi se subjekti Ndue Doçi numrin e tij personal e ka H11051***A.
- Gjithashtu subjekti ka deklaruar, se për mobilimin e shtëpisë në vitin 1994, ka shpenzuar rreth 60.000 lekë si dhe për biznesin e b/shortes rreth 726.000 lekë.
- Për periudhën deri në ditën e plotësimit të formularit të deklaramit të pasurisë, janë shpenzuar për arsimimin e personave të lidhur, në total 4.000 euro (financiar nga shtetasi D. D.)
- 117. Drejtoria e Përgjithshme Detare me shkresën *** prot., datë 10.5.2023, nuk konfirmon mjet lundrues në pronësi të subjektit dhe personave të lidhur.
- 118. ISSH me shkresën nr. *** prot, dt. 10.05.2023, nga viti 2012 që ka të dhëna, konfirmon se S. Doçi, për periudhën qershor 2021 - gusht 2021, ka qenë i punësuar pranë: PF D.D. Me inventarin nr.extra prot., datë 10.07.2023. subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI: Subjekti ka dhënë shpjegime me shkrim ku shpjegoi se djali S. Doçi gjatë periudhës së pushimeve verore ka punuar për 3 muaj pranë shoqërisë "****" sh.p.k., shoqëri që zotërohet nga djali i xhaxhait të subjektit, D.D. Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me sa konfirmuar nga ISSH për punësimin e djalit të tij, S. Doçi.

Trupa e Vlerësimit ka kryer një hetim të thelluar të kontrollit të pasurisë së subjektit të vlerësimit dhe personave të lidhur nëpërmjet verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit dhe korrespondenca me institucionet ligjzbatuese.

Tabela e analizës financiare për periudhën 1998- 2022 si më poshtë:

Bilanci/Neto	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	TOTALI	
Te ardhura neto nga paga apo spherhime nga marrredhmet e punesimit	103,522	325,178	426,932	428,668	470,477	660,349	511,532	725,891	839,033	892,954	821,391	1,041,460	879,551	1,217,860	921,597	1,014,483	1,041,681	1,041,441	1,047,881	1,256,880	1,336,961	17,005,722	
Te ardhura neto nga paga apo spherhime nga marrredhmet e punesimiti Bashkeshorje nga tete 2002	24,553	132,594		19,375	120,674	196,380	140,290	175,200	133,179	553,209	541,528	520,523	122,095	116,561	609,014	884,999	343,692	325,739	177,566	213,120	339,136	5,689,427	
Te ardhura neto nga qerati																							
Te ardhura neto nga aktivitetet privat ekonomik																					173,305	935,254	1,108,559
Te ardhura nga aktivitetet bujqesore																							
Te ardhura neto nga interesat bankare																						67,548	67,548
Te ardhura nga vendimet gjyqesore															289,325	344,680						633,975	
Totali i TE Ardhurave neto	128,075	457,772	426,932	448,043	591,151	856,729	651,822	901,091	972,212	1,446,163	1,362,919	1,561,983	1,001,646	1,334,421	1,819,936	2,244,132	1,385,373	1,367,180	1,225,447	1,643,305	2,678,899	24,505,231	
Dejtime: Te hyra nga luate/kredit/dhurim																							
Shpenzime jetike sipas INSTAT	78,010	218,428	280,836	332,136	332,136	942,912	546,480	853,008	853,008	853,008	558,192	558,192	944,568	953,484	982,740	970,500	1,028,868	1,107,192	1,118,700	1,138,608	1,188,144	15,839,150	
Shpenzime per Qera																				50,000	120,000	120,000	290,000
Shpenzime per Muerje shtepi me qera																				40,000	100,000	140,000	
Shpenzime per Arsimimin																						440,000	440,000
Shpenzime Uthetimit jetike vendl																							
Shpenzime legalizim banese																						154,000	154,000
Shpenzime Biznesi																						726,151	726,151
Totali i shpenzimeve dhe te dalave	78,010	218,428	280,836	332,136	332,136	942,912	546,480	853,008	853,008	853,008	558,192	558,192	944,568	953,484	982,740	970,500	1,028,868	1,147,192	1,148,851	1,258,608	1,748,144	17,589,301	
Investime me bono thesari																						1,700,000	1,700,000
Blerje makine							924,000				500,000											1,424,000	1,424,000
Depozite																	470,000					470,000	470,000
Gjendje Cash + ne Hogari								924,000				500,000						470,000				120,491	120,491
Totali Pasuri	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1,820,491	3,714,491
Mundesia per Kurrsime : Te Ardhura+Dejtime Shpenzime-Pasuri.	50,065	289,409	435,505	551,412	810,427	724,244	94,414	46,331	72,873	666,028	970,735	1,974,546	2,031,624	2,412,561	3,249,757	4,523,389	1,861,051	2,081,039	1,157,635	1,542,332	652,596	3,201,439	

B. KONTROLLI I FIGURËS

Ojekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.”

119. Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës për subjektin e vlerësimit Z. Ndue Mark Doçi, bazuar në përcaktimet e dispozitës së nenit 4, pika 1, gërma b dhe neneve 35 - 42, 48 dhe 51 e 52 të parashikuara në ligjin nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” të ndryshuar.

120. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre elementë:

1. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
2. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
3. Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gërma (ë), e ligjit 12/2018, i ndryshuar.

121. Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit Z. Ndue Mark Doçi, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.

122. Struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (AMP) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit Z. Ndue Mark Doçi, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim të identifikojë nëse subjekti i vlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në ligjin 12/2018 të ndryshuar, ka dërguar një raport të detajuar me shkresën nr. *** prot., datë 03.10.2023, për subjektin e vlerësimit, në përputhje me nenin 42 pika 2 të ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar, dhe konstaton se:

Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

Për subjektin e vlerësimit Z Ndue Mark Doçi , me funksion Drejtor në Drejtorinë Vendore për Kufirin e Migracionin Gjirokastër, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. dhe "personave të lidhur", nuk administrohen të dhëna, fakte apo prova, që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, apo që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:

- a. Deklaratën e Kontrollit të Figurës
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore

Në deklaraten për kontrollin e figurës, pjesa e parë, shtojcën 1, subjekti deklaron:

- ✚ Gjeneralitetet
- Se nuk ka pasur emër apo mbiemra të tjerë më parë,
- Se nuk është njohur nga të tjetër me ndonjë nofkë apo mbiemër tjetër,
- Se nuk ka pasur nënshtetësi tjetër,
- ✚ Në deklaraten për kontrollin e figurës, pjesa e dytë, shtojca 1, subjekti deklaron të dhënat përkatëse mbi vendbanimin,
- ✚ Në pjesën 3 dhe 4, të shtojcës 1, subjekti ka deklaruar të dhëna ndër vite lidhur me arsimin, kualifikimet, specializimet apo trajnimet dhe punësimin përkatës
- ✚ Në pjesën 5, të shtojcës 1, lidhur me të dhënat e sigurisë subjekti ka deklaruar:
- Nuk është dënues ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj,
- Nuk ka qenë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një veprë penale.
- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një veprë penale.
- Nuk ka qenë caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo.
- Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, bashkëjetuesi/t, si dhe personat e përfshirë në çertifikatën familjare) është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.

- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdo lloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së Subjektit.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit sipas përcaktimeve të ligjit për intergritetin e personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keqprezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe të një natyre sigurie të veçantë apo gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie apo të ketë nëpërkëmbur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas ligjit “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
- Nuk vuajtur nga çrregullime mendore kronike.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkolit apo lojrave të fatit.

123. Po ashtu, subjekti ka nëshkruar edhe dy vetdeklarimet për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

❖ **Hetimi i kryer nga Trupa Vlerësuese e AMP:**

Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektin e vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36, të ligjit nr. 12/2018, datë 05.06.2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë kryer veprimet e duhura duke kërkuar të dhëna nga institucionet të shprehura në këtë ligj si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile,
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit,
- Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes,
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve,
- Prokurorisë së Përgjithshme,
- SHISH,

- DPPP,
- Autoritetit për Informimin mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit,
- Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar,
- Avokatit të Popullit,
- SPAK,
- Drejtorisë së Analizës dhe Sigurimit të Personelit në AMP,
- Drejtorisë së Inspektimit dhe Ankesave në AMP.

Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, Trupa e Vlerësimit konstatoi se:

- **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile** me shkresën i “kufizuar” Nr. ***, dt. 06.06.2023, për subjektin e vlerësimit z. Ndue Mark Doçi konfirmon se:
 - *Nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve të subjektit të vlerësimit z. Ndue Mark Doçi.*
- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën i “kufizuar” nr.*** datë 19.05.2023 konfirmon se:
 - *Nuk është i dënuar.*
- **Institucion ligjzbatues** me shkresën “I kufizuar” nr.*** datë 30.05.2023 dhe me shkresën “e paklasifikuar” nr.*** datë 30.05.2023 konfirmon se për subjektin z. Ndue Mark Doçi dhe personat e lidhur sipas çertifikatës familjare:
 - *Nuk ka dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;*
 - *Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar") ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj;*
 - *Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, te nenit 3, te Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar;*
 - *Nuk ka të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale;*
 - *Nuk ka të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale;*
 - *Nuk ka të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhëri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;*
 - *Nuk ka të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;*
 - *Nuk ka të dhëna në lidhje nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS-S;*
 - *Nuk ka të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet.*
 - *Nuk ka procedim disiplinor apo masë disiplinore.*

- **AIMS** me shkresën “Konfidencial” nr.*** datë 31.05.2023 për subjektin e vlerësimit z. Ndue Mark Doçi konfirmon se:
 - *Nuk disponon të dhëna.*
- **Institucion ligjbatues** me shkresën “Sekret” datë 13.06.2023 dhe shkresën “Sekret” nr.*** datë 21.06.2023 për subjektin e vlerësimit z. Ndue Mark Doçi dhe personat e lidhur sipas çertifikatës familiare konfirmin se.
 - *Nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundraligjshëm;*
 - *Nuk ka procedime penale të referuara;*
 - *Nuk administrohen ankesa, të dhëna ose informacione që lidhen me objektin e kërkesës;*
- **Institucion ligjbatues** me shkresën “I kufizuar” nr.*** datë 30.06.2023 për subjektin e vlerësimit z. Ndue Mark Doçi bën me dije se:
 - *Nuk ka nxjerrë urdhër ndalimi*
 - *Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal dhe nëse po, vlerësimi i tyre nga gjykata*
 - *Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të K.P.P*
 - *Nuk ka patur regjistrim të njoftimit të veprave penale*
 - *Nuk ka pasur raste të urdhërave ndërkombëtar të ndalimit*
- **Nga një institucion tjetër ligjbatues** me shkresën “i kufizuar” nr.*** datë 08.06.2023 për subjektin e vlerësimit z. Ndue Mark Doçi konfirmon - *Nuk rezulton të jetë rregjistruar procedim penal.*
- **Nga një institucion tjetër ligjbatues** me shkresën “Sekret” nr.*** datë 25.05.2023 për subjektin e vlerësimit z. Ndue Mark Doçi dhe personat e lidhur sipas çertifikatës familiare, bën me dije se:
 - *Nuk rezultojnë raportime.*
- **Autoriteti Kombëtar për Sigurimë e Informacionit të Klasifikuar** me shkresën “I kufizuar” nr. *** datë 25.05.2023 për subjektin e vlerësimit z. Ndue Mark Doçi bën me dije se.
 - *Është pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli(CSP), niveli i klasifikimit “Tepër Sekret” me nr.*** me datë lëshimi 24.02.2022 dhe e vlefshme deri më datë 23.02.2027.*
 - *AKSIK, për subjektin e vlerësimit nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP-së.*
 - *AKSIK nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.*
- **Avokati i Popullit** me shkresën “E paklasifikuar” nr.*** datë 30.05.2023 për subjektin e vlerësimit z. Ndue Mark Doçi bën me dije se:
 - *Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime ose mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.*
 - *Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.*
- **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentat e ish-Sigurimit të Shtetit** me shkresën “I kufizuar”nr.*** datë 08.06.2023 bën me dije se:
 - *Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i shtetit deri me 02 Korrik1991.*

124. Pranë Trupës Vlerësuese, nuk janë paraqitur denoncime nga publiku ndaj subjektit të vlerësimit Ndue Doçi , për shkelje të rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, sipas parashikimit ligjor të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

125. Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit z. Ndue Doçi në zbatim të pikës 2, të nenit 38 të Ligjit 12/2018, të ndryshuar, me shkresën nr. *** prot. datë 06.11.2023 të Institutit Mjekësisë Ligjore protokolluar me tonën nr.*** datë 08.11.2023 ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara të testimit për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se:

- Në mostrën e *** marrë subjektit me kod shifror 191***, mbyllur në kontenier, nuk u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të MOP (opiate/heroine), COC (cocaine), MTD (metadon), THC (canabinoide/cannabis sativa), BARB (barbiturate), TCA (tricklike antidepressante), AMP (amfetamine), MDMA. (ekstazi), LSD (acid lisergjik), BZO (benzodiazepina).

Në përfundim të hetimit të kryer:

126. Trupa Vlerësuese, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr. 12/2018 (i ndryshuar), nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, analizimin dhe verifikimin e të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjensitë ligjzbatuese, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit Nr.12/2018 (të ndryshuar), vëren se, nga sa rezulton deri në mbylljen e hetimit administrativ të subjektit të vlerësimit Z.Ndue Doçi lidhur me komponentin e figurës, informacioni i deklaruar nga subjekti është i saktë dhe i besueshëm.

C . VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

127. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

128. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- a. të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, ligjit 12/2018, i ndryshuar;
- b. raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standartet profesionale në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës, Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit 12/2018, i ndryshuar

129. Subjekti i vlerësimit Z.Ndue Mark Doçi, në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin, Drejtor në Drejtorinë Vendore për Kufirin e Migracionin Gjirokastër, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

130. Punonjësi i policisë z. Ndue Doçi është emëruar në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Gjirokastër me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. *** datë 16.12.2022.

131. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore me shkresën nr. *** datë 19.04.2023, në zbatim të nenit 43-47 të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar, ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit hartimin e raportit të Vlerësimit të Aftësive Profesionale për subjektin e vlerësimit z. Ndue Doçi.
132. Vlerësimi i Aftësive Profesionale nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për subjektin e vlerësimit Z. Ndue Doçi, bazuar në nenin 47, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar me shkresën nr.*** prot., datë 30.06.2023 protokolluar me tonën nr. *** prot. datë 05.07.2023 arrin në përfundim se:
Punonjësi i policisë z. Ndue Mark Doçi, është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar funksionin që mban.
133. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e vlerësimit, është kryer në përputhje me kreun V, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, bazuar në nenet 43-46, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
134. Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale sipas përcaktimit të nenit 43 të këtij ligji, ka të bëjë me vlerësimin e nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe pozicionin, respektimin e rregullave të etikës, si dhe përmbushjes së detyrave nga subjekti në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e Policisë së Shtetit.
135. Raporti i vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në:
- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit me nr. 18***.
 - Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore RMIS me nr. 900****.
 - Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44 pika 1, e ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si edhe në dokumentacionin shoqëruar të paraqitura nga vetë subjekti.
 - Të dhënat e siguruar nga Drejtoria e Standarteve Profesionale mbi Performancën e Subjektit.
136. Të dhënat e siguruar konfirmojnë nivelin arsimor, ecurinë në karrierë dhe në gradë, trajnimet, kualifikimet, inspektimet apo ankesat në drejtim të subjektit nga Drejtoria e Standarteve Profesionale apo institucionet e tjera mbikëqyrëse si Avokati i Popullit Komisioneri për të Drejtat e Njeriut, Komisioneri kundër Diskriminimit, KLSH, si edhe vlerësimet e punës të cilët për subjektin objekt vlerësimi përveç vitit 2018, të tjerat mungojnë.
137. Nisur nga ky konstatim Trupa Vlerësuese e AMP me shkresën nr. *** datë 14.07.2023, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit ku kërkohet informacion/dokumentacion në lidhje me vlerësimet e punës për subjektin, për periudhën 2019-2020-2021-2022.
138. Me shkresën nr.*** datë 21.07.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit konfirmon se, në lidhje me vlerësimet e punës për periudhat 2019,2020,2021,2022 ju konfirmojmë se për këto periudha kohore ky subjekt nuk ka të administruara në dosje vlerësime pune.
139. Në lidhje me këtë fakt me emailin e datës 02.11.2023 subjektit ju kërkua që të japi shpjegimet e tij.

Në kthim përgjigjen e tij protokolluar me tonën nr.***prot. datë 10.11.2023 subjekti sqaron se: *Vlerësimet e punës bëhen çdo fund viti, përjashtuar rastet e veçanta. Pasi njihemi me to dhe i nënshkruajm administrohen nga personeli në Dosjen Personale. Kjo praktikë ndiqet për çdo punonjës të Policisë së Shtetit. Unë nuk kam pasur në ndonjë rast rezerva ose kundërshtime për vlerësimin e bërë me qëllim që, të kërkoja administrimin e kopjes sime për të ezauruar rrugët e ankimit sipas ligjit. Vlerësimet e mia të punës kanë qenë “Shumë Mirë”. Fakti që nuk ekzistojnë në dosjen personale më bëhet i njohur nga Ju gjatë këtij procesi. Unë me një e-mail të datës 06.11.2023, kërkova t'më vihen në dispozicion vlerësimet për periudhat 2019,2020,2021 dhe 2022. Nga përgjigjia e ardhur nga personeli i DKM rezulton që, Vlerësimet e Punës t'mos jenë administruar apo arkivuar në Dosjen Personale, e cila ndodhet në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. (e-maili bashkëlidhur). Por në rrethanat kur Komisioni është i pa qartë dhe pa burim prove për këtë kriter vlerësimi, do të kërkoja të administrohen para komisionit deklaratimet ligjore të eprorëve të mi ndër vite, ose sipas përzgjedhjes që Ju mund të bëni.*

140. Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit arsimor dhe përshtatshmëria me kriteret e pozicionit të punës sipas parashikimeve të nenit 45/2/a të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

141. Në të dhënat e administruara në dosjen personale rezulton se subjekti ka përfunduar arsimin si më poshtë:

Niveli i arsimit	Institucioni ku janë ndjekur studimet	Fillimi	Përfundim	Vendi	Titulli/ Diploma
Arsim i Lartë	Akademia Policise Ankara,Turqi	1998	2002	Turqi	Diplomë
Arsim i Lartë "Bachelor"	Fakulteti Drejtësisë "Justicia"	2008	2011	Tiranë	Diplomë

- Akademia e Policisë Ankara,Turqi. Filluar në vitin 1998 dhe përfunduar në vitin 2002, me nr. Diplome 11***, numër amze shkolle 981***, datë regjistrimi 1996 dhe datë përfundimi 2002 (kjo sipas përkthimit zyrtar të V. Gj. me nr. Licensë “****” dhe vërtetuar nga notere L. H. me nr. *** rep. datë 07.07.2002.)
- Arsimi i Lartë “Bachelor” në Fakultetin e Drejtësisë “Justicia” filluar në vitin 2008 dhe përfunduar me 2011, numër amze USTESA000*** datë 31.01.2012, Diplomë nr. 000***.
- Subjekti i vlerësimit është angazhuar në trajnime profesionale. Ai u ka kushtuar rëndësi trajnimeve që kanë të bëjnë me objektin e tij të punës.
- Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit, rezulton së ai ka kryer trajnimet/specializimet si vijojnë:

	Viti	Emërtimi i trajnimit	Lloji dokumentit
1.	2002	Kurs Kompjuteri	Certifikatë
2.	2004	Kurs Trajnimi Falsifikimi i dokumentave në vendet evropiane	Certifikatë

3.	2005	Kurs Trajnimi Taktikat speciale të hetimit të krimit të organizuar	Certifikatë
4.	2007	Trajtimi i fëmijëve në konflikt me ligjin	Certifikatë
5	2007	Trajnim ndërkombëtar për hetimin penal	Certifikatë
6.	2008	Kur Trajnimi "mbrojtja e të dhënave "	Certifikatë
7.	2009	Kurs Trajnimi, Kodi i sjelljes dhe komunikimi me qytetarët	Certifikatë
8.	2009	Kursi i Menaxhimit të Krizes WMD	Certifikatë
9.	2009	Trajnimi për ndalimin e portot detar ndërkombëtar II	Certifikatë
10.	2011	Kurs Trajnimi i Trajnerëve Autorizohet të udhëheq programe trajnimi sipas nevojave të Policisë Shtetit	Certifikatë
11.	2013	Për ngritjen e nivelit të mësimdhënies	Certifikatë

142. Në kuptim të ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar neni 44, pika 2, subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale ka kryer vetëm një trajnim dhe ka marrë certifikatë “Për procedurat e sigurimit të personelit dhe sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale” viti 2018 Tiranë.

Konkluzion i Trupës Vlerësuese

143. Në kuptim të legjislacionit për Policinë e Shtetit dhe në ligjin në fuqi Nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, Trupa e Vlerësimit arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, që në kohën e emërimit në detyrë për herë të parë në Policinë e Shtetit dhe deri në vijueshmërinë e ecurisë në karrierë të tij, ka qënë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor. Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit të vlerësimit rezultojnë se subjekti ka kryer trajnime dhe specializime dhe për këtë ka marrë edhe certifikatat përkatëse.

144. Për periudhën 5 vjecare objekt i ligjit 12/2018, i ndryshuar ka kryer trajnimin, sipas deklaratimit të subjektit por që në raportin përfundimtar të vlerësimit të aftësive profesionale nga DPPSH nuk përmendet. Certifikata “Për procedurat e sigurimit të personelit dhe sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale”, viti 2018, Tiranë.

Në dosjen personale të subjektit për periudhën 2018-2022, rezultojnë se janë administruar 1 (një) vlerësim pune, 4 (katër) mungojnë.

1. Vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2018 27 pikë (shumë mirë)
2. Vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2019 Ska
3. Vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2020 Ska
4. Vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2021 Ska
5. Vlerësim i rezultateve të punës për vitin 2022 Ska

Për periudhën e fundit 5(pesë) vjecare 2018-2023 të përcaktuar në pikën 2, të nenit 44, të ligjit 12/2018 të ndryshuar subjekti i vlerësimit nuk është ndëshkuar disiplinisht me masë disiplinore. Në formularin e aftësive profesionale për vlerësimin kalimtar si objekt vlerësimi nuk ka angazhim në Konferenca Shkencore, Workshop-e, Seminare si edhe botime brenda dhe jashtë vendit.

145. Në ligjin 12/2018, i ndryshuar, neni 45, "Burimet për vlerësimin e aftësive profesionale", pika 2, gërma "c" *certifikata e trajnimeve dhe medaljet*, pika "ç" *vlerësimet e punës*, janë element kryesor për vlerësim të aftësive profesionale të subjektit të vlerësimit. Bazuar në konstatimet e mësipërme Trupa Vlerësuese e ka të vështirë që të arrij në një konkluzion që subjekti i vlerësimit të ketë përmbushur me korrektësi detyrat funksionale, respektuar rregullat e etikës si edhe të ketë shfaqur një performancë të mirë në kryerjen e detyrave funksionale. Nga verifikimi në dosjen e subjektit si edhe në sistemin RMIS, për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh 2018-2022, siç kërkohet në pikën 2, të nenit 44, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, subjekti i vlerësimit nuk është ndëshkuar disiplinarisht me masë disiplinore.

ECURIA NË KARRIERË

146. Subjekti i vlerësimit ka një karrierë prej 20 vite dhe 9 muaj. Gjatë periudhës 5 vjecare subjekt i ligjit 12/2018, të ndryshuar, subjekti ka deklaruar se ka këtë ecuri në karrierë:

Data e fillimit		Data përfundimit		Institucioni	Funksioni	Emri dhe mbiemri i punëdhënësit apo eprorit të drejtpërdrejtë	Adresa e plotë e institucionit	Arsyeja largimit
Muaji	Viti	Muaji	Viti					
17-12-2022		Aktualisht		Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit Gjirokastër	Drejtor	Muhamet Rrumbullaku	Bulevardi "Bajram Curri", Nr. 240: Tiranë	Vazhdim
12-03-2019		16-12-2022		Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit	Drejtor	Ardi Veliu	Bulevardi "Bajram Curri", Nr. 240: Tiranë	Transferim
11-06-2018		11-03-2019		Drejtoria Përgjithshme Policisë së Shtetit	Shef Sektori Kufirit të Gjelbër në Drejtorinë e Kufirit	Ardi Veliu	Bulevardi "Bajram Curri", Nr. 240: Tiranë	Transferim
16-11-2017		10-06-2018		Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	Shef Sektori, i Sekretariatit dhe Arkivës DPP	Haki Çako	Akademia e Sigurisë, Sauk Tiranë	Transferim

147. **Ecuria në Gradë e Subjektit të Vlerësimit Z. Ndue Doçi.**

- i. Me urdhër të Drejtorit Rajonal të Kufirit dhe Migracionit Vlorë Nr. *** datë 30.06.2008 “Për dhënien e gradës policore një punonjësi policie”, Inspektor Ndue Mark Doçi, me detyrë Shef Sektori, në Stacionin e Policisë Kufitare Port-Vlorë, në Sektorin e Shërbimeve Operacionale, në Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Vlorë, i jepet grada policore “Komisar”.
- ii. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë nr.*** datë 24.04.2009 “Për ngritjen në gradë të një punonjësi policie” ka urdhëruar që Komisar Ndue Mark Doçi me detyrë Shef Sektori ai dhe specialist, në Sektorin e Migracionit, në Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Vlorë, ka përfunduar me sukses kursin e trajnimit për gradë, i jepet grada policore “K/Komisar”
- iii. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë nr. *** datë 13.03.2013, “Për ngritjen në gradë të një punonjësi policie”, ka urdhëruar që K/Komisar Ndue Mark Doçi me detyrë Z/Drejtor Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda në DPQ Gjirokastrë, ka përfunduar me sukses kursin e trajnimit për gradë, i jepet grada policore “Drejtues”.

HETIMI I KRYER NGA TRUPA VLERËSUESE

148. Në Vendim të KM Nr.803, datë 21.11.2007, “Për përcatimin e funksioneve koresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimi i tyre”, pika 1, Funksionet koresponduese, për çdo gradë, sipas ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe ekuivalentimi i tyre me gradat e marra, sipas ligjit nr.9643, datë 20.07.2000 “Për gradat në Policinë e Shtetit”, përcaktohen në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, Grada “Inspektor” për pozicionin “Shef Stacioni i K&M”, pozicion të cilin mbante subjekti i vlerësimit, konvertohet në gradën policore “Komisar”.

✓ **Trupa Vlerësuese konstaton se, marrja e gradës nga “Inspektor” në “Komisar” është dhënë në përputhje të plotë me ligjin.**

149. Nga shqyrtimit i dokumentacionit në dosjen e subjektit me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. *** datë 24.04.2009 “Për ngritje në gradë të një punonjësi policie” bazuar në nenin 42, pika 1 dhe 2 shkronja “b”, e ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007, “Komisar” Ndue Mark Doçi pasi ka përfunduar kursin e trajnimit për gradë, i jepet grada policore “K/Komisar”.

150. Në ligjin Nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, neni 41, pika 5, gërma “a”, *Punonjësit të Policisë i lind e drejta të aplikojë për të konkuruar në procesin e përzgjedhjes, pas plotësimit të kohës së qëndrimit në gradë, sipas afateve të mëposhtme:* v) nga “Komisar në “Kryekomisar” 3 vjet. **Në fakt kanë kaluar 10 muaj.**

Në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, neni 44, fillimi i procedurës për vlerësimin e aftësive profesionale pika 2, *“Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet”.*

151. Nga shqyrtimit i dokumentacionit në dosjen e subjektit me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. *** datë 13.03.2013 “Për ngritje në gradë të një punonjësi policie” bazuar në nenin 42,

pika 1 dhe 2, shkronja “b”, e ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007, “K/Komisar” Ndue Mark Doçi pasi ka përfunduar kursin e trajnimit për gradë, i jepet grada policore “Drejtues”.

- ✓ **Trupa Vlerësuese konstaton se marrja e gradës nga “K/Komisar” në “Drejtues” është dhënë në përputhje me ligjin duke respektuar të gjitha afatet kohore.**

Trupa Vlerësuese pranë A.M.P ka kryer një hetim të thelluar të kontrollit të aftësive profesionale për subjektin e vlerësimit Ndue Mark Doçi, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e Aftësive Profesionale, analizimin dhe verifikimin e të dhënave të mbledhura, për subjektin e vlerësimit z. Ndue Doçi, **konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimi e aftësive profesionale.**

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa Vlerësuese e AMP, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit z. Ndue Doçi në përputhje me nenin 60 të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë,
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës,
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit e AMP , bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar:

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit, Z. **Ndue Mark Doçi**, me funksion Drejtor në Drejtorinë Vendore për Kufirin e Migracionin Gjirokastër, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë **20.12.2023**

TRUPA E VLERËSIMIT

Suela Bulku

Kryesuese

Arben Sefaj

Denisa Sina

Relator

Anëtare